

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

834-32

T.65

Shfaqet  
Tigani

MJEGULLA  
E ÇARE

Tregime

891.983-32

T 65

SHEFQET TIGANI

S

# MJEGULLA E ÇARË

*Tregime*

56323

3079.



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## FËMIJA E UZINËS

Ai po rendte për të kërkuar taksì. Ishte shumë vonë dhe rrugët ishin pothuaj të qeta. Vetëm hapat e ndonjë polici të vetmuar dëgjoheshin tek-tuk. Ai vraponte për në vendin e taksive.

— Vëlla... shpejt... gruaja — tha me një frymë.

— Hyrë njëherë, pa e shohim pastaj... — foli i përgjumur shoferi. — Ku të të shpie?

Ai i dha adresën duke ju marrë fryma.

— Është fëmija e parë... E kanë zënë të prerat... shpejt... në maternitet!

Llambat neon dhe apartamentet e përgjumura, me ndonjë dritë të ndezur tek-tuk mbeteshin nga pas.

— Çfarë do të të lindë?

— Fëmijë.

Shoferi qeshi.

\* \* \*

Punonin të dy në një kantier. Ndërtohej një uzinë për llamba elektrike. Ai ishte vincier, kurse ajo punëtore. Ata erdhën kur objekti sapo kishte fi-

lluar të hidhte shtat. Ai me vinçin dhe ajo me brigadën e muratorëve.

Ishte i ashpër, i vrazhdë dhe thërriste fort. Ajo në fillim e mori zët.

— Ej, Luli! — i bërtiste ai — Shokët janë pa llaç... luaj duart!

— Dëgjo... — thërriste Luli nga poshtë duke vënë duart buri. — M'u bëre si burri i nënës. Dy duar kam të shkretat...

— Shpejt... lëri llafet!

Ai donte që vinçi të mos rrinte kurrë pa punë. Po pse ishte vinçi në fund të fundit? Për të çuar lart materiale për ustallarët. Po kur ustallarët nuk kanë, bie fjala, tulla, llaç a beton, përse të rrijë ai kot pa punë?! Dhe ai thërriste me gjithë grykën. Pa ç'ka se Luli poshtë zemërohej.

— Punë e madhe!... Ka ardhur për të punuar? Duhet t'i luaj duart... Sytë i ka të bukur qenja...

Luli të binte në sy që nga flokët e lidhur bishtkali, pantallonat e ngjitura pas kofshëve, sytë e zez dhe vetullat e lëpira, deri tek buzët e fryra e të bukura.

Vajza punonte me inat ndërsa mbushte kovën me llaç. I vinte parangon dhe, kur vonohej që ta ngrinte, bërtiste ajo pastaj.

— Ore Rakip... ngrije... muhabet bën? — Ai qeshte.

Një herë, kur Luli mbushi kovën me tulla dhe po priste që të ngjiteshin lart, Rakipi i thirri:

— Luli... hip edhe ti... është bukur... Të duket sikur fluturon.

Ajo ndjeu gudulisje në gji. I erdhi mirë. Megjithatë i thirri:

— Ore... Rakip! Shiko se e ke zgjatur shumë gjuhën!

— E shkurtoj sa të duash. Po deshe e zë me buzë... ja... dhe e kyç fare.

Asaj i erdhi keq që i foli ashtu.

Të ngjitej lart dhe ajo? Të ulej në kovën e vinçit që ngrihej sikur fluturonte? Pastaj, të shkonte në kafazin e tij dhe t'i mbështeste kokën në gjoks? Sa herë në gjumin e saj rinor kishte ëndërruar ta mbështeste kokën në gjoksin e tij. Kur zgjohej, ndjente keqardhje dhe trishtim. Në punë ishte e gëzuar, dëgjonte zërin e tij, të qeshurën e tij.

Pastaj erdhi ajo që pritej.

Një natë kishin mbrëmje vallëzimi. Ata kërcyen shumë herë bashkë. Një herë e merrte ajo dhe dy herë e merrte ai. Atë natë Luli e ndjeu veten të lumtur. Rakipi skuqej dhe e ledhatonte kur fijet e flokëve të saj i çiknin ballin. Luli mezi e mposhte tundimin për të mbështetur kokën në gjoksin e tij. Fluturonin në krahët e njëri-tjetrit duke qeshur e duke bërë qyfyre. Në fund ai i kërkoi ta përcillte deri në shtëpi dhe Luli nuk kundërshtoi. Ecnin në një rrugicë të errët, ku s'dëgjohej këmbë njeriu. Ai i hodhi dorën në qafë. Luli u mundua t'ja hiqte. Ai e la krahun atje ku ishte dhe ajo s'u ndie më.

— Luli... të dua për grua. — i tha ai. Ajo heshti. Gjoksi i saj nuk heshte. Ai i shtrëngoi fort supet.

— Luli... — të të puth një çikë?

— Mos e tepro... i tha ajo. Sytë e saj dukeshin të butë e të dashuruar.

— Një çikë!

Ai e puthi. Ajo ndjeu dridhje, ngrohtësi, dridhje,

Shokët kishin qejf të kërcenin me Lulin, kurse shoqet me atë, Rakipin dhëndërr. Filloi të endej midis vallëzuesve ajo kapelja e Shefikut, që vente kokë më kokë, dhe çiftet ndërroreshin me radhë.

Ndonjë skeptik pinte dhe vështronte me keqardhje çiftin duke menduar:

«Ike, Rakip... vate djalëria... Papo do të të pllakosin hallet familjare, pastaj...»

Shokët qeshnin dhe vallëzonin, hidhnin thumba, bënin qyfyre. Natën vonë u larguan duke uruar.

Çifti shkoi të flerë.

Atë natë ata biseduan edhe për fëmijën e tyre të parë.

\* \* \*

— Luli, të kam sjellë portokalle. I kam lënë poshtë te portieri.

— Mirë.

— Çfarë do të të sjellë Rakipi ty?

— Çfarë të duash ti.

Luli kishte dalë në dritare me ata flokët e lëshuar mbi vesh. Ai qëndronte poshtë në rrugë dhe s'ngopej duke e vështruar. Në kuadratin e dritares i dukej si një pikturë e bukur dhe e qartë.

— Luli, si është çupa?

— Si kukull. — Fytyra i shkëlqente nga lumturia.

Rakipi e vështronte i malluar. Mallëkoi maternitetin, që s'kishte një dhomë takimi, por e kishte detyruar të qëndronte e të thërriste nga rruga, ku e dëgjonin të gjithë. Donte t'i thoshte se e kishte marrë malli shumë, se donte të shikonte çupën...  
1

po si dreqin, kur në rrugë kalojnë kaq shumë njerëz dhe automjete!

— Luli, nëna u mërzit që s'bëre djalë.

— S'ka gjë.

— Shokët dhe shoqet do të vijnë mbasdite.

— Mirë.

— Po iki, Luli.

— Mirë.

— Të të sjell ndonjë gjë për të ngrënë?

— Mirë.

\* \* \*

Ajo vazhdonte të rrinte në dritare.

«Po ikën. Sa i mirë është. Ashtu i vrazhdë, i singertë dhe i dashur. Babai i çupës! Sa i paarritshëm më duket, kur është lart në kafazin e vinçit. Duket i vogël, dhe atje brenda i shquhet vetëm koka e tij e qeshur. Mbi vinç ai bëhet i fortë, me krahe të hekurt, që ngrenë peshë tonelata materiale dhe i çojnë në lartësi. Rakipi im! Ai që po zhduket në rrugë në morinë e njerëzve dhe automjeteve. Babai i çupës!

Më kujtohet ajo ditë kur u bë inaugurimi i uzinës. Unë doja që ta shikonte nga kafazi i vinçit, kurse ai erdhi i thjeshtë, me atë hapin e rëndë dhe të çrregullt, me një tufë lule në dorë. U pre shiriti dhe vizitorët hynë nëpër reparte. Ai erdhi në laborator.

«Gëzuar uzinën e re!» më tha.

«Gëzuar!» i thashë.

«Të na bësh një fëmijë të fortë» më tha.

«Do ta bëj» i thashë.

Më dhuroi lulet dhe unë i vura në vazo.

«Ti, s'deshe të rrije në uzinë» më tha.

«Desha të shkoja me brigadën time» i thashë.

«Është bukur të prodhosh në një uzinë, të cilën e ke ndërtuar vetë.»

Po të ishim vetëm në laborator do ta kisha puthur.

«Më në fund qëndrova, mbarova dhe kursin. Megjithatë do të doja të punonim bashkë në objekte të tjera» thashë.

Buzëqeshi. Ai me gjithë mend është i mirë...»

Ajo qëndronte ende në dritare. Vështronte një brez deti në horizont, çatit e shtëpive, oxhaqet e uzinës së saj. Përfytyronte shoqet duke punuar.

Kishte lindur fëmijën e parë. Po ta llogarisje që nga inaugurimi, kishte lindur fëmijën e parë në uzinë. Ajo e përfytyronte uzinën si frymor që ka jetën e vet. Hidhet fara (lind mendimi në kokën e njerëzve), fillon projektimi, hapen themelet, ngrihen muret. Njerëz që punojnë, djersijnë, dashurojnë, pjellin fëmijë. Merr formë objekti, futen maqineritë dhe lulëzon fruti i të gjithave, prodhimi. Bashkë me prodhimin lindin fëmijët e parë e kështu uzina krijon traditën e saj. Ajo kishte lindur fëmijën e parë pas inaugurimit.

Filloi të ëndërronte. Në përfytyrimin e saj gazetarë energjikë dhe fjalëshumë, me blloqe në duar.

«Ju jeni... Muratore. Shumë mirë... Pastaj kaluat në uzinë... Laborante... Lindët...»

Shokë nga radio Tirana me manjetofonë në duar.

— Të dashur dëgjonjës... po ju njohim me shoqen... që lindi...



— Kujdes, shoqe, buzëqesh pak... Duhet ta shikosh më me dhemshuri e dashuri fëmijën... ajo është fëmijë e madhe, fëmijë uzine... Kujdes kamera! Mund të dilte në pëlhurën e bardhë të kinemasë dhe Rakipi të bënte shaka me të:

«Pa, pa, pa, yll kinemaje nuk të dija!

Në mendje ajo ja kishte vënë emrin vajzës Drita.

Përsëri ai brez deti, ato çati shtëpish dhe poshtë njerëz që u thërrisnin të afërmve dritareve.

Në një çast u skuq dhe i erdhi turp që kishte në vete përfytyrime të tilla.

Mbylli dritaren.

\* \* \*

Në pasdite erdhën shokët dhe shoqet. Ata ishin shumë. Qëndronin poshtë në rrugë. Bisedonin me zë të lartë dhe i hidhnin thumba njëri-tjetrit. Ajo i vështronte e ngazëllyer. U thërriste me emra, u thoshte që ishte mirë dhe që çupën e kishte si top. Njëri nga ata i tregoi Rakipin dhe i thirri, se e kishin marrë edhe atë me vete.

— Shumë mirë bëtë — tha Luli — po të na urdhëroni dhe në shtëpi, kur të dal këndeje.

Ata i premtuan se do t'i shkonin të gjithë në shtëpi.

Edhe kur u larguan, në mend i mbetën ato koka të qeshura e të sinqerta.

Harroi të mbyllte dritaren.

## YJET

— A të kujtohet? Ne atëhere u ngjitëm në tarracën e shkollës për të vështruar yjet me teleskop. Ti qeshje. I luteshe profesorit të vështroje i pari. Mbylle njërin sy, dhe tjetrin e mbështete mbi gypin e teleskopit. Sa çudi! Ti s'kishte parë ndonjëherë. Një sfond i errët, me yje që feksnin si xixëllonja. Jupiteri duke notuar në një det mjegulle. Disa njolla të zeza. Yjet... Ti qeshje, qeshje e s'doje të largohesh nga teleskopi.

«Ilir, të shohin dhe të tjerët,» — të tha profesori. Ti e lirove teleskopin më tepër nga bindja se sa nga dëshira.

Sonte yjet janë të ftohta. Ato të duken të çuditshme. Ti ecën me çizme të llangosura nga balta. Nganjëherë ngre kokën. Jupiteri të vështron në mënyrë të dyshimtë. Ti buzëqesh. Nganjëherë vrëjtësh. Puceta plot ujë. Ai derdhet arave duke gurgulluar. Saraçineskat nxijnë e të duken të përbindshme. Ti i shikon dhe vrëjtësh. E ujët duhet të kalojë në tubacion.

— Si t'ja bëj?

Tani ti zhvishesh dhe lëshohesh në atë pucetë.

Dhe Jupiteri i ftohtë, i qartë të vështron. Zhytesh. Ftohët. Trupi të rrëqethet, të mbulohet me mornica por ti...

— Të kujtohet? Ne shkonim dimrit të luanim futboll bregut të detit te plazhi. A e di si të duket plazhi në dimër? Për të ardhur keq. I braktisur, i zbrazët e i ngrysur. Kur luanim ne, ai qeshte pak, kur iknim, trishtohej. Ti luaje sulmues i djathtë. Shënoje gola më shumë nga të gjithë. Kur mbaronim lojën, ti shikoje detin. Të pëlqente shumë deti kur ishte i pastër, i shkëlqyer nga dielli dhe i mbështjellë nga rrezet si nga një vello najloni. Po kur laheshe? Ne të përcillnim me britma gëzimi (e mban mend?). Kur dilje ngrefoseshe pak dhe ja merrje vrapit bregut.

Ti tani kridhesh në atë pucetë. Errësirë, po me hamendje ti i gjen saraçineskat. Si të tendosen nervat. Sa e fortë kjo saraçineska. Po të lodh shumë, por ti nuk epesh. E shtrëngon fort. E rrotullon. U mbyll? Të lumtë, Ilir! Dil tani nga puceta! Ke ftohët? S'ka gjë, do të të kalojë. Rrobat janë tutje tek ai guri. Vishi tani. Ndofta do të zhvishesh prapë, megjithatë vishi njëherë.

Çizmet të futen thellë në baltë. Ti nuk i shikon, po ato lënë pas gjurma gropëzash. Është një poemë e shkruar në baltë në këtë natë plot yje! Ndofta nuk është e fundit poemë që do të shkruash.

\* \* \*

— O Ilir!

I dëgjon? Janë shokët që vijnë pas teje! Edhe ata shkruajnë në llumin e kënetës poemën e tyre.

Shokët e tu, që kontrollojnë linjën e tyre të tubacionit. Buzëqesh? Ke të drejtë; është mirë kur njeriu nuk e ndjen veten të vetmuar në këtë natë të ftohtë. Prapa ndrin një pishtar. Shokët e kanë ndezur për të ndriçuar rrugën. Ai duket së largu në errësirë si një far i ndezur. Tani ti je më i guximshëm. Të është zhytur këmba gjer në gju? Kapu diku, mbahu fort! Është dobësi të qëndrosh ashtu i përkulur.

Yjet i ke mbi kokë. Sa shumë yje! Shiko: Kasiopea si një dubël vë e përmbysur. Konstelacioni i palëvizshëm. Ne jemi mijëra yje që përbëjmë një konstelacion gjigant në qiellin tonë blu. Si t'ja vëmë emrin, Ilir? Kjo s'ka shumë rëndësi... U ngrite? Ecë tani...

Përsëri shokët! Ti vë duart buri përpara gojës e u kthen përgjegje. Gjithshka në rregull? Ecë përpara tani...

Ej, tutje zbrazëtisë së errët diçka e madhe shkëlqen. Një shkëlqim i bardhë, si dëborë e butë, kur i bien sipër rrezet e diellit. Është uzina jote, Ilir. Gjiganti i ngritur mbi rërë, buzë detit, është gati. Vetëm ujët mungon. Tani ti ecën nëpër llumin e kënetës që t'i çosh ujët uzinës.

...Atje ishte pyll. Ne shkonim pas shkollës, me çantat në supe për të vrarë mëllënja. Kishte shumë mëllënja. Ne vrisnim gjithmonë dhe shkonim të gëzuar në shtëpi. Ty nëna të përgëzonte dhe na jepte të dyve nga një fetë bukë me vaj e kripë në dorë. Ne ishim komshi. Po kur shkonim me xhaxhanë tënd për të vrarë rosa të egra? Ti i luteshe të gjuaje me çifte, po ai s'të linte.

— Jo, harxhon kot fishekët!

Ty të vinte inat dhe gati sa s'qaje.

Tani rosa të egra s'ka fare. U trembën që kur u ngrit kantieri. Mëllënjat u larguan ca. Kur kalon pyllit, çercëritjet e tyre të kujtojnë fëmininë.

Së largu, errësirës shikon një shkëlqim të bardhë. Uzina jote që pret të fillojë nga provat.

\* \* \*

Përpara vezullime dritash të zbeta. Janë dritat e Panajasë. Ato duken se diç të pëshpërisin me gjuhën e errësirës. I shikon dhe mendon se ke për të bërë ende një rrugë të gjatë. Prapë t'u zhyt këmba në llum? S'ka gjë, së shpejti mbi gjurmët e tua do të kalojë plugu i traktorit. Këneta do të tharhet. Ti e ke parë maketin e tharjes së saj të afishuar në qytet. Lejlekët do t'i ndërrojnë foletë. Nuk do të verojnë më mbi ato ujëra të ndenjura.

Ecë tani...

— O Ilir!

— O-o-o!

Në uzinë do të brohorasin kur t'u shkojë ujët. Si e quajti drejtori? Lulja e parë e komunizmit?.. Ç'xhanan burrë që është ai drejtori. Ti e dëgjon kur flet në mbledhjet e gjera të kolektivit dhe do të mos mbarojë kurrë së foluri.

Ç'punë është bërë, Ilir! Të kujtohet kur montonit kolonat e karbonatimit? Kur vendosnit tubat në freskuesit... Po kur mbete brenda në kolonë tri orë? Ti qesh kur e tregon. Shpatullat të ishin bërë plagë. Hyre brenda në kolonë. Monto e monto nga ata tubat dy metra e gjysmë, të gjatë dhe harrove se duhej të dilje. Kur u kujtove, daljen e kishe

zënë me tubat e montuar. Kishe mbetur brenda.  
...U thirre shokëve të të ndihmonin. Ç'të bënin ata!

— Zbërthe disa tuba, Ilir!

Ti i zbërtheve. Disa të ranë shpatullave. T'u rop  
lëkura dhe, kur dole, bulëza gjaku të ishin mpiksur  
në të.

E dëgjon atë fërshëllimë? Vrapo, Ilir! Ajri shfryn  
në mënyrë të përbindshme. Sapo të çlirohet ajri,  
saraçineska duhet mbyllur menjëherë. Si e shpon  
këtë natë të ftohtë kjo fërshëllimë. U çlirua?..  
Mbylle saraçineskën tani! Puceta ka shumë ujë, de-  
ri në brez.

Nise prapë hapin tënd të madh e të lodhur mbi  
llumin e kënetës. Ai hap të çon përpara drejt atij  
shkëlqimi të bardhë. E... Së shpejti do të fillojë  
prodhimi. Ti do të qëndrosh vigjilent pranë apa-  
rateve. Në kolonën e karbonatimit do të kalojë sus-  
pens. Ti do ta ndjesh se si do të rrjedhë nëpër dejet  
e kolonës. Si e ëndërron atë ditë! Po s'është e lar-  
gët, si nuk është e pambarim rruga që bën. Suspens,  
suspens në kolonat... Shokët pranë aparateve tre-  
guese dhe tutje soda e kalçinuar paketohe. Pas-  
taj soda kaustike mbyllet në fuçi të hermetizuara.  
Ajo është e përzier me djersën tënde, të shokëve  
të tu, Ilir.

Ecë drejt atij shkëlqimi të bardhë...

\* \* \*

Mbrapa ndrit një pishtar me dritë të kuqërrem-  
të. Duket si një shkëndijë zjarri. Sikur të kishe një  
zjarr të madh tani. Ti ke nevojë të ngrohesh. Je  
krejt i lagur. Ja dhe dritat e Nartës. Këneta duket

e përgjumur. Nga gjiri i saj dëgjohen krakaritje shpesësh të natës. Në perëndim ca re puplore shëndrisin me rreze ari nga hëna e re, që duket si thua i prerë. Duket sikur hëna është ulur e kullot në një fushë zhabinash. Ç'bukuri e ftohtë dhe magjepsëse. Ilir! Kjo bukuri të bën të ëndërrosh. Për çfarë mendon tani? Nuk është shumë vonë. Do dhe dy orë të bëhet mesnatë. Është natë dimri dhe njerëzit qëndrojnë pranë zjarrit duke kuvenduar. Ç'bën Eli? Eli me gërshet. Ty të pëlqen të lozësh shumë me gërshetin e saj. E merr e ja vërtit rreth qafës. Ajo shtiret e zemëruar dhe të gotet lehtë me pëllëmbë në faqe. Atëherë ti e shtrëngon në krahë me dashuri dhe e puth. Kur do të mblidhemi në shtëpi për fejesën tënde me Elin? Hë, Ilir?! Do të sjellim dhe orkestrën e uzinës. Po ne jemi shumë, Ilir... Shtëpia jote nuk na nxe. Ne do ta bëjmë fejesën tënde në këndin e kuq të uzinës. Pse qesh? Ne duam të marrim pjesë të gjithë në gëzimin e shokut.

— O Ilir!

Janë ata që do të marrin pjesë në fejesën tënde në këndin e kuq të uzinës.

Të mbetet dhe pak rrugë për të bërë. Do të të përgëzojnë të gjithë, kur të arrish në uzinë. Ti do të skuqesh nga turpi... nuk të pëlqejnë lavdërimet.

— Ç'bëra unë? punën time...

Edhe Eli do të krenohet.

Harusha e madhe ka varur kokën në perëndim. Ti kërkon me sy Yllin Polar. Nuk je dhe ti një yll? Po, vëllaçko, një yll i vogël në atë konstelacion gjigant.

Yjet i ke mbi kokë. Sa shumë yje! Yje të tjera të vijnë nga pas duke të thirrur hera-herës. Zëri i

tyre të ngroh në këtë natë dimri të acartë. Sa shumë  
yje të vijnë nga pas. Këta janë yje revolucionari, Iliri!  
Ecë akoma edhe pak. . .

1967



## MARIA

*Nuset vishen në të bardha dhe ikin me taksì tek burri. Vjeshta është e nuseve.*

### 1

Sa shumë njerëz janë mbledhur. Shokë dhe shoqe të miat, shokë dhe shoqe të çupës. Ata të çupës janë të rinj. Këndojnë këngë të reja nga ato që jep radioja në çdo emision të muzikës së kërkuar. Ata të mitë kanë qejf këngët labe, bisedat e shtruar, kurse gratë vallet e kënduara, shoqëruar nga njëherë dhe me def. Më në fund ja arrita dhe kësaj dite. M'u rrit çupa, gjeti një burrë dhe tani po bëjmë dasmën e saj. Asnjëherë s'ma kishte marrë mendja që do ta martoja me kaq bujë. Dikur duheshin shumë pare për të bërë dasmë. Sot unë pothuaj s'po harxhoj fare. Ata të rinjtë kënaqen me të kënduar dhe me të vallëzuar. Fizarmonikën e kanë sjellë vetë. Edhe oborrin para shtëpisë e shtruan vetë. Erdhën një ditë dhe punuan: ngjeshën tokën, e ujitën, e rrethuan me stola, vunë ca llamba elektrike që llamburitën sikur të jetë ditë dhe aty këndojnë, aty vallëzojnë. Ana nuk mbahet. Ajo vazhdimisht qesh. Dikur, kur martoheshin, qanin. Sot nuset vi-

shen në të bardha, ikin me taksi tek burri dhe qeshin. Shoqet i rrinë pranë. I rregullojnë flokët, palat e fustanit dhe s'ngopen së përkëdheluri me fjalë dhe thumba pa të keq. Ajo është e qeshur dhe e lumtur. Edhe unë qesh dhe jam e lumtur. S'di përse lumturia nganjëherë të ardhka me lot.

Njerëzit vijnë valë-valë me pako në duar. Sa shumë peshqeshe po i vijnë çupës sime. Ata rrinë ca këndojnë, ikin, vijnë të tjerë. Shtëpia më duket si një sallë e madhe ekspozite, e zhurmshme dhe gazmore, ku hyjnë e dalin, bisedojnë, kënaqen, thonë fjalë të mira dhe ikin për të ardhur të tjerë.

— Marie, të të trashëgohet çupa! Me jetë të lumtur dhe shqyrr që ja arrite kësaj dite!

— Faleminderit, po përse u harxhuat?

— Ua, ç'janë këto fjalë Marie! Për çupën tënde të vetme...

Mua më mbushen sytë me lot dhe të gjithë më japin të drejtë.

## 2

Qyteti ishte i vjetër, me rrugët gjithë gropa nga bombardimet me kanale në të dy anët e rrugës, ku vareshin ca akacje të deformuara. Pjesa më e madhe e shtëpive të shkatërruara. Lufta kishte lënë gjurmë në rrugët, në shtëpitë, deri tek rrudhat e nënave.

Filluam nga rindërtimi. Unë hyra në një brigadë muratorësh. Isha punëtorë dhe ndihmoja ustallarët. Punuam shumë për të mëkëmbur shtëpitë e vjetra, derisa u ngritën kantiere të reja, filluan të ndërto-

heshin apartamentet e para, u asfaltuan rrugët e para. Unë punova ngado.

E njoha vite më vonë, kur punonim për ndërtime e fabrikës së çimentos. Ai ishte murator i mirë, njeri i mirë dhe për më tepër shok i mirë. Ne punonim bashkë.

Në mal kishim harruar se ishim femra. S'na shkonte ndër mend të shiheshim në pasqyrë, të zbukuroheshim për t'u pëlqyer burrave. Na qëllonte shpesh të flinim në një vend me shokët, të ecnim në monopate të shkreta me shokë, dhe s'na shkonte mendja për asgjë të keqe. Ne i dallonim shokët, i quanim trima, të guximshëm, të mirë dhe nuk na shkonte mendja për cilësi të tyre, që kishin të bënin me seksin tonë.

Kur u çliruar, filluam të mendojmë edhe për vete. U pashë njëherë në pasqyrë. U kujtova se edhe unë isha femër, se mund të dashuroja dhe të bëja fëmijë.

Ai ishte i fortë, motër! Të mbërthente në vend me atë fuqinë e tij. Punonim dhe hanim bashkë. Na pëlqente të rrinim shtruar pranë një zjarri, që e ndiznim në pushime. Kuvendonim për luftën, për shokët që na u vranë, për ata që punonin ngado dhe diçka na bashkonte, na lidhte më shumë.

Kisha filluar ta shikoja atë edhe si burrë. U martova me të, thjesht, pa ceremoni. Unë prindërs'kisha, veç disa të afërm. Prindërit më ishin vranë në luftë. U veshja në të bardha dhe u martova. Ai dinte të puthte mirë motër. A harrohet dot e puthura e parë? Më mbërtheu fort dhe ndjeva në rremba se si më përshkoi fuqia e tij.

Ai ishte i fortë, ju betohem për këtë...

Donim djalë, po na lindi Ana.

— Është bukur të ndërtosh, Marie!

Ai kishte shpirt ndërtuesi. Kur ngjitej skelave, më dukej më i madh, më i fortë. Kështu e kujtoj gjithmonë: me mistri në dorë, me plumçe e çekan, duke ngritur mure e duke u dhënë forma ndërtesave.

Pastaj më la. E ndjeva shumë humbjen e tij. Në katin e lartë dikë zuri korenti. Thirrje të alarmuara. Britma. Ai shkoi ta ndihmonte duke u ngjitur skelë më skelë. Diku i shkau këmba nga shpejtësia dhe ra. S'e dëgjova më zërin e tij. Më la, motër. E doja shumë. Dashuria e vonë qenka e fortë. Ne provuam një dashuri të vonë. E pata të vështirë të ndahesha nga ajo dashuri. Për mua ai ishte shok, komunist, vëlla, burrë dhe babaj i çupës sime. Më la, motër...

Kortezh i madh. Banda e qytetit na shoqëronte me një marsh funebër. Unë gjithmonë i përfytyroj kortezhet duke ecur në shi. Qielli pus. Ca të rralla vetëtima. Gjëmime të largëta. Njerëz kokulur, që përcjellin të afërmin, shokun. Në krye ai. E mbanin shokët në krahë, duke u ndërruar me radhë. Më pas kurora nga ndërmarrja, nga shokët e partisë dhe të pushtetit. Pastaj banda. Pastaj unë. Nuk më besohej asgjë nga ajo që ndodhte. Për mua ai ishte i gjallë dhe jetonte.

«Ndërtimi është më i vështirë se lufta, Marie. Ndërtimi kërkon edhe viktima. Jo më kot në legjenda bëheshin kurbane kur ndërtohej diçka. Edhe jetën do ta japim, po të duhet, Marie.»

Komunisti i Maries!

Kortezhi u ndal në vorrezat e dëshmorëve. U

mbajtën fjalime. Banda ekzekutonte marshe partizane.

*Atëhere ajo qëndiste bukur. «Marie — i thanë — na qëndis një flamur». Dhe e kishte qëndisur. «Marie, shpërndai këto trakte në qytet. Me kujdes, Marie, se ka spiunë» — Dhe ajo i kishte shpërndarë. Kishte bashkëpunuar me grupet ilegale. Kohë të vështira. Kishte dalë në mal. Net marshimesh. Të pangrënë, të papirë, të paveshur. Morali gjithmonë lart. Duheshin vrarë shumë nga ata bij bushtrash që të hanin dhe të pinin, të visheshin mirë dhe të ishin të lirë njerëzit.*

*Dhe kishte vrarë shumë...*

— Mbahu, shoqja Marie! Edhe këtë radhë të duhet guxim dhe trimëri!

— Mbahem, shok. Kam parë shokët kur na janë vrarë përpara syve dhe nuk kam qarë. Vetëm urrejtja na shtohet. Këtë radhë do ta kem shumë të vështirë, megjithatë do të mbahem.

— *Shoku komisar, na vdiq Arifi!*

*Ata kishin dy ditë e dy net brenda në një shpellë; të rrethuar gjatë operacionit të dimrit. Shpella ishte e madhe, e ftohtë dhe pikonte vazhdimisht. Nerva të acaruar. Uri. Të shtëna provokuese të herëpashershme. Gjithë batalioni ishte atje. Mbldheshin kruspull, shtrëngoheshin për t'u ngrokur me njëri-tjetrin. Nën shpellë dyqind metra humnerë. Arifi kishte ditë që ishte sëmurë dhe më në fund u kishte vdekur. I miri, trimi, gazmori Arif! I rrinin.*

pranë. Nuk qanin. Vetëm urrejtja u shtoej. Ah bijtë e bushtrave, që u kishin vrarë Arifin. Ah!

— Shoku komisar! Nuk mundemi më! Të dalim këndeje dhe t'u biem, shoku komisar! Ashtu si dimë ne, shoku komisar! Na lërë për Arifin, shoku Komisar!

Shpella pikonte në mënyrë të çmendur! Dridheshim nga të ftohtit dhe urrejtja.

— Ne duhet të qëndrojmë këtu, shokë partizanë! Është detyrë partie, shokë partizanë!

Atë e vendosën në varr si partizan. Dy ushtarë bënë roje nderi me automatikët në gjoks. Hodha dhe unë një grusht dhé në varrin e tij. Komunisti i Maries! Dëgjon të shtënat e pushkëve? Janë për ty, o komunisti i Maries! Do ndërtojmë o shokë, o burrë, ashtu siç doje ti, siç ëndërroje ti.

Lamtumirë, o komunisti im!

4

Kështu, shoqet e mia, motrat e mia.

Ditët e para për mua ishin të vështira. Shkoja në punë, ngrija kokën skelave dhe atë s'e shikoja gjekundi. Zhytesha në punë.

— Marie, një kovë llaç!

— Ja burazer, erdhi!

Shokët më qëndronin pranë, më ndihmonin në punë. Nganjëherë, kur ustallarët nuk kishin nevojë për gjë, ulesha, vështroja kantierin, zhytesha në zhurmat e tij. Në çaste të tilla dëgjoja edhe zërin e Asllanit tim. Objekti po ngrihej dhe mua më dukej se ai punonte akoma në të. Së shpejti do të mba-

ronte dhe do të prodhohej çimento. Ne kishim shumë nevojë për çimento. Pastaj ne do të iknim andej. Do të shkoni në kantiere të reja.

Në çaste të tilla më hipte një dëshirë dhe entuziazëm i madh për të punuar.

Kur kthehesha në shtëpi, ajo më dukej e zbrazët. Merrja çupën në kopësht. Ishte rritur, fliste mirë dhe bënte çapkënllëqe zbavitëse. Ju e dini sa të këndshme janë çupat në moshë të tillë. Rrugës, duke u kthyer për në shtëpi, ajo më çuquriste në vesh vjersha dhe llafe të panumërta si një zoçkë. Rrija në shtëpi me çupën. Futesha në mendime, trëmoja në kujtime, shikoja në fotografitë dhe prisja të dëgjoja hapa, të kërciste dera, të hapej, të hynte ai, ashtu i qeshur, i shëndetshëm dhe i fortë. Hapa dëgjoheshin me të vërtetë, por hynin shokët e tij, shokët dhe shoqet e mia. Rrinin me mua, bisedonin dhe s'e ndjeja veten të vetmuar.

Dhimbja kur ndahet me shokë, bëhet e vogël dhe kalon shpejt.

Edhe mua më kaloi shpejt.

Një ditë ju paraqita drejtorit në zyrë. Ishte edhe sekretari i partisë aty. A ishin të kënaqur shokët e partisë dhe të drejtorisë me punën time? Bah, ç'ishte ajo pyetje! Me punëtore si unë ata krenoheshin. Shumë bukur! Po sikur unë të specializoheja si muratore? Si muratore?! Dreq o punë, një grua muratore?

— Ide e bukur! — tha sekretari.

— Dua të ndërtoj... .

— Po a mundesh, shoqja Marie? — tha drejtori.

— Ne jemi brez i fortë, do të mësoj.

— Të lumtë, Marie... . Ti do bësh pastaj edhe muratore të tjera si veten.

Fillova të mësoj, të ngre mure, të përdor plumçe dhe mistri. Kalova në shumë kurse, vazhdova edhe shkollën e mbrëmjes. Kisha gjithmonë punë dhe kjo më jepte një kënaqësi të veçantë.

5

Kantieret lindin në vende shterpa. Zakonisht në fusha me ferra dhe shkurre. Kantieret prishin jetën e zakonshme të shpendëve, insekteve, gjarpërinjve a bretkosave. Ndizen zjarre, ku digjen grumbujt e shkurreve dhe barishteve. Hapen themele në forma hieroglifesh pakuptim. Grumbullohen shumë materiale. Fillon një jetë e re, e zhurmshme, me burie maqinash që shkarkojnë vazhdimisht materiale. Kantieret kështu fillojnë jetën e tyre të bujshme: ditë ndërtimelesh dhe net betonimesh.

Ajo njohu shumë kantiere të tilla. Vitet kalojnë shpejt dhe lënë gjurmë. Vitet e saj ishin të pasura, të ngarkuara me gëzime dhe shqetësime, me brengë dhe dashuri për njerëzit. Vitet atë e ashpërsuan. Plaga e vjetër i zuri kore dhe ajo s'e ngacmonte më. Mendonte ndonjëherë për të, por kjo ndodhte në çdo përvjetor të brigadës së tyre partizane. Mbledheshin të gjithë shokët e luftës, rreshtoheshin në formacionet e dikurshme, nderonin partizance me grushtin shtrënguar dhe të ngritur lart. Këta përvjetorë ishin ngjarje të mëdha në jetën e saj.

Në takime të tilla ajo fliste për kantieret. Tregonte dhe për Asllanin e saj, që i donte aq shumë kantieret dhe ndërtimet.

Dhe përsëri për të fillonte jeta e zakonshme e kantierëve.



Ishte trashur ca. Vishte pantallona dhe çizme. Në kokë mbante shami. Kështu në çdo kohë. Në dimër ngjishte dhe një peliçe me pambuk. Kishte hap të matur, të rëndë, burrëror. Edhe dorën ta shtrëngonte si burrë.

U qëndronte pranë njerëzve, u qante hallet dhe me sa mundte i ndihmonte.

Një herë kishte parë atë, Shegën, që ishte martuar aty një vit e gjysmë më parë dhe kishte lindur një djalë. Shega kishte ditë që vinte e ngrysur dhe e mërzhitur në punë. Nuk thoshte një fjalë dhe dukej se nga çasti në çast do t'ja shkreppte të qarit. Maria e kishte marrë pranë vetes një ditë.

— Hë, Shegë, ç'ke?

— Unë, asgjë nuk kam.

— Hajde, hajde, mos më fshih mua!

— Për kokë... nuk kam asgjë...

— Folë de tani!

Ah, ai burri i saj, i poshtri... E kishte mpleksur me një tjetër dhe atë s'e përfillte!

— Më rreh, Marie, më ka mbyllur brenda dhe s'më nxjerr asnjëherë shëtitje.

— I poshtri... Hajde me mua ti.

E kishte marrë prej dore dhe kishin shkuar te sekretari i partisë.

— Dëgjo, shoku sekretar, ca burrave si i kësaj, u duhen shtrënguar vidhat.

— Dale, Marie, më ngadalë!

— U duhen shtrënguar vidhat dhe pikë!

Kishin bërë një mbledhje kolektivi. Kishin thirrur dhe atë burrin e Shegës. Ja kishin treguar atij se si mund të merrte gruan nëpër këmbë...

I erdhi në kantier dhe Ana. Ajo mbaroi shkollën dhe punonte si teknike ndërtimi. Edhe Ana

me pantallona, por ajo ishte e re dhe e qeshur. Nganjëherë e drojtur.

— Mos u druaj, moj çupë. Jeta duhet marrë ashtu si të të vijë. S'ke përse të druhash. Njeriu duhet të tregohet ai që është. S'është nevoja të shtihesh dhe të veshë llustër. Ne punëtorët tregohemi ashtu siç jemi dhe nuk fshehim asgjë. Këtu qëndron sekreti që ne korrim fitore dhe gëzojmë dashurinë e të tjerëve. Tregohu ashtu siç je, dhe të gjithë do të të vlerësojnë.

. . . . .  
— Marie, do të ta marr çupën!

Ai i thërriste poshtë nga maqina, kurse ajo ishte lart në katin e pestë të bikarbonatit.

— Mos thirr, o dreq!

— Do të ta marr si grua, dhe ty do të të kem si nënë.

Shejtani, sa i paturpshëm që ishte!

— Dëgjo... Po ja mbushe mendjen, merre. Ti më pëlqen. Dhe ikë tani!

— Marie, edhe ti do të jetosh me ne.

— Ikë, o dreq!

Ai i pëlqente. Ishte i gjallë, punëtor, shofer i zoti dhe... i bukur. Edhe çupës do t'i pëlqente. Pa tjetër do t'i pëlqente. Më kot s'i kishte parë bashkë disa herë, duke çuquritur pranë maqinës së tij, duke qeshur.

— Ja dhe çupa ime e gjeti burrin.

6

Në mbasdite erdhi dhëndrri me taksi. Atmosfera u bë më e gëzuar. Përzierje këngësh dhe instru-

mentash. Më një anë dëgjohej defi, në anë tjetër fizarmonika. Këngët labe u vinin kapak dhe dukej sikur qëndronin pezull në këtë atmosferë.

Sikur në jetën e njeriut të ketë vetëm dasma!

Kështu, o shoqet e mia, motrat e mia. M'u martua dhe çupa.

Më morën dhe mua në taksi. Shkova tek dhëndrri. Dikur bota do të qeshnin për këtë. Unë nuk çava kokën. Kisha kohë që kisha filluar të mos çaja kokën për shumë gjëra që s'më dukeshin të drejta mua.

Edhe atje dasmorë që prisnin. Këngë labe. Nuk di përse në përfytyrimin tim del deti sa herë dëgjoj këngët labe. Ai deti i madh dhe i gjerë, që duket se do të thotë shumë gjëra me atë gjuhën e tij të dallgëve. Këngët labe janë si deti; në to mpleksen miliona dashuri të thëna dhe të pathëna, heroizmi popullor, krismat e pushkëve dhe era e barotit.

Shoqet e mia, motrat e mia! A më jepni lejë të më rrëshqasin dy pika lot? Kështu, o shoqet e mia...

U ngritën dolli. Kënduan dhe vallëzuan deri natën vonë. Ja çupa shkoi të flerë në dhomë me atë... Çamaroku i Maries, i guximshmi i Maries, djali i Maries! Dëgjon, o djalë i Maries, duhet të jesh i fortë!

Ç'mendoja dhe unë budallaçka...

Ata shkuan të flenë...

Qetësi. Kisha nevojë për atë qetësi.

Natën e mirë, fëmijë e mi, dhe më qofshi të lumtur!

Kështu, shoqet e mia, motrat e mia.

## BOTA E DULES

«Unë ju vështroj tek notoni. Më duket se ju vështroj prapa një xhami. Kënaqem kur ju shoh, por prapë dua t'u zë me grep,» — mendonte ai me vete, duke vështruar peshqit nën këmbët e molit tek godisnin grepin.

I qëllonte shpesh të mendonte, se e tillë ishte puna e tij. I mbetej shumë kohë edhe të mendonte, edhe të hidhte një gotë birra. «Birra gjë e mirë, po të bën të derdhësh ujët e hollë çdo gjysmë ore».

Më shpesh mendonte duke peshkuar, kur anija ishte pa punë, e akostuar në krye të molit; në mëngjez herët pa lerë dielli dhe në mbrëmje vonë, shumë vonë, pasi ngopej në palmet me gjumë gjithë mbasditen. Rrinte përkulur mbi tonjon dhe vështronte thellësinë: në mëngjez, kur ujët ishte kristal poshtë dhe netve, kur fari i portit derdhte në det ngjyrën e kuqe të ndezur si currila vere. Atëhere ai mendonte dhe për veten dhe për botën.

Sa shfaqej nga mezokanali ndonjë njollë tymi, që afrohej gjithnjë e më tepër duke marrë trajtën e një vapori, dhe kur në gjithë gjirin ushtonte klithma e ndonjë sirene të huaj, nga molua nisej një

anije e vogël, që ngjante së largu me një mjellmë me bark të fundosur. Sa arrinte anija e bardhë, vaporit hidhte spirancat thellësisë. Atëhere ai e çonte vështrimin drejt e tek flamuri. Dhe më shpesh i qëllonte të shante... të shante ndyrë, ashtu siç i vinte për gojë. Shokët ja dinin huqet dhe nuk nxeheshin me të. Bile dhe ata, kapiteni i portit dhe ushtari, që i shoqëronin gjithmonë në këso rastesh, qëllonte shpesh që vinin buzën në gaz, ose i hidhnin ndonjë thumb. Atëhere ai, i nxehur më keq, nxirrte goxha të sharash nga goja.

— Ai që nuk shan nuk është detar — thoshte për t'u shfajësuar.

Kështu, kur ishte çisternë e çonin drejt kampit, e lidhnin mirë e mirë në bova dhe e linin pastaj në punë të tij. Shkonin më të rrallë, kur i thërrisnin ose kur marinarët donin të dilnin në qytet. Kur ishte nga ata vaporët me hambarë, e binin drejt e në molo. E akostonin duke lidhur litarët kaluneve dhe pastaj fillonin nga puna vinçat. Ai s'kishte punë tjetër. Edhe kuvertën më të rrallë e pastronte, se për atë punë kishte djemtë. Kështu i quante dy më të rinjtë e ekuipazhit. Atij i mjaftonin grepat.

\* \* \*

Fliste nëpërmjet mendimeve, jo me zë. Ai nuk e ndjente shumë vetminë që të fliste me zë. Më të rrallë ngrinte kokën nga tonjua dhe hidhte një vështrim nga vinçat që gumëzhinin. Ç'ishte e vërteta atij i pëlqente zhurma e vinçave, shoqëruar nga zërat e mbartësve:

— Majna, majna! po ata vinçat që punonin me avull ai s'i duronte dot. I ngjanin me një vrap kali të hasdisur. Vështronte marinarët e huaj që vërtiteshin hambareve, disa që lyenin, po kur dilte në kuvertë ndonjë femër dhe atë nuk e duronte dot.

— Marrin dhe femra në vapor... pu, pu, pu, ku kanë arritur! Sikur s'bëjnë dot pa to. Pa le... më del dhe me kostum banje mbi kuvertë, bushtra...

Më të rrallë qeshtë, por kur i hipte në kokë s'pushonte për një kohë të gjatë. Kështu i kishte ndodhur dhe atëhere kur kishin shkuar të mernin ata marinarët gjermanë, që donin të dilnin në qytet. Dy prej tyre i kishin mjekrat...

— *Si vurrë... tamam si vurrë këpucësh. Hë, Leko... duhet të fshihen mirë këpucët me mjekrat e tyre. A-a-a!*

— Dule, ngrehu, se do vemë të marrim ata **italianët**, që kanë kërkuar të dalin, — i tha atij njëri nga djemtë.

— Ja se erdha, sa të mbledh tonjon.

Po të mos e ngacmoje, ai mund të rrinte një kohë të gjatë pa folur. Djalli e merrte vesh se ç'bluante në atë kokën e tij tullace.

— Dule, dukesh i mërztur sot, — e trazoi marinari i ri flokëkaçurrel me gishtin tregues të dorës së djathtë të prerë. I duhej shumë gishti, por prapë e kishte prerë. Një pakujdesi, një fluturim mendjeje dhe një gisht i prerë. Kështu kishte ndërruar zanat...

— I mërztur the? Jam ca vërtet, se u zura me gruan.

— **Me gruan?**

— Dava e gjatë. U bë tërkuzë. Nuk ua kam thënë, por pardje më lindi nusja e djalit çupë. Vete

në maternitet me gruan dhe i flasim nga dritarja. «Si je moj? — Mirë — thotë. — Po çupa si është? — Si top — thotë» «Dule, shih t'ja vëmë emrin Luxiana» — më thotë gruaja. «Ç'djall Luxiana, moj! Shpresa, Shpresa» i them. Se nga dëgjojnë nga këta emrat: Luxiana, Luçiana, Periana. . .

— Po çfarë tha gruaja? — e nxiste ai djali me gisht të prerë.

— Vari buzët. Epo hak e kam, si thua ti? Pak emra të bukur kemi ne, që vëmë e vëmë Luxiana. . . Çupës së madhe ja kam vënë emrin Vjollca. Lloissha çfarë emri t'i vija. Para se të shkoja në gjendjen civile për të regjistruar çupën, kthehem tek reklammat e kinemasë. Shoh që ishin mbedhur kokë më kokë. Ç'është, more? — pyes. — Ka dalë filmi «Shitësja e vjollcave» — më thotë një çunak. Më mbeti në kokë emri Vjollca. Kështu de. . .

Anija bëri një kthesë dhe vajti allaj vavorit italian.

. . . . .

Dulja ishte mbështetur mbi fil të anijes dhe diç po bisedonte me një marinar italian. I dha dhe një nga ato cigaret «Partizani» me yll. Italiani desh t'i jepte një «Çestërfild», po Dulja nuk ja mori. Rrudhi buzët dhe tregoi me shenja se ishte e butë dhe s'e pinte dot.

— Çfarë të thoshte italiani? — e pyeti Dulen djali me gisht të prerë, kur anija lundronte për t'u kthyer në molo.

— Ai. . . Uguu. . . më tregonte se si ishte tmeruar nga një partizan. Kishte qenë fashist këlyshi i kurvës. Më tha se, po ta kishte sjellë rasti të ishim

takuar në luftë, ai do më kishte vrarë mua ose unë atë. Tha se ato i kishte lufta dhe se atë e kishin mashtruar. Dukej i penduar maskarai. Në djall të venë... s'kemi nge të merremi me ta.

Dhe heshti... Një kredharak po e ndiqte anijen në fluturim. Pastaj qëndroi lart në dyrek dhe pa u trembur nga lëkundjet. Dulja e vështronte: «Ikë, o kredharak, ikë në punën tënde! Këtu s'gjen gjë për të ngrënë. Ikë gjëkundi tjetër, në gjtsh të gllabë-rosh diçka...»

\* \* \*

Mërzitej Dulja kur anija shkante për remont kapital në kantier. Derisa t'i vinte radha anijes të dilte në tokë dhe derisa ta kryente remontin bëheshin plot dy muaj. Kishte ndodhur të qëndronte edhe më shumë anija në kantier. Kjo ishte gjëja më e mërzitshme për të. E parë e punës do të merrte lejen bashkë me pushimet e prapambetura të të dielave, që venin më shumë se një muaj, pastaj pjesën tjetër e kalonte në kantier.

*U mërzitka njeriu dhe me pushime. S'di si ta kalosh kohën. Do të pish kafe me ndonjë dopio fërrnet tek çami, ku mblidhen gjithë detarët, do të bësh ca muhabet, pastaj...*

Nuk ishte gjë e lehtë për Dulen të shkëputej nga bota e tij. Vërtet që i kishte kaluar të pesëdhjetat, po s'mund t'i duronte ca burra në moshë të thyer, që gjithë ditën shkonin nëpër duar tespijet. Gjithë dimrin mblidheshin në kafene. Sa ngrohte koha në pranverë dhe gjithë verën, derisa ftohej koha në vjeshtë, luanin domino, tavëll a letra në



lulishten pranë detit. Nuk ishte për atë jetë Dulja dhe e kuptonte më tepër kur anija shkonte në kantier. Atëhere atij i duhej të shkëputej fare nga ajo pjesë e botës rreth së cilës i pëlqente t'i nxishte mendimet.

Edhe kur mbaronte pushimet, (ai kurrë nuk arrinte t'i mbaronte plotësisht) dhe nisej në kantier për të zëvendësuar ndonjë shok, prapë mërzitej. Por jo më tepër se sa kur i duhej të pinte kafën me fërrnet dhe disa kriko birra në ditë, pasojat e të cilave ai i njihte mirë. Në kantier të paktën do të kishte për se të mendonte. Do të vërtitej me kutinë e bojës në dorë në të gjitha vërat dhe zgëqet e anijes: në palmet, hambar, do të lyente timonerinë, kamarinën deri në pjesën e brendshme të motorit. Megjithatë në çdo orë do të dilte në kuvertë, do të zbriste poshtë anijes nga shkallët prej litari dhe do të ulej më tutje mbi ndonjë piring dërrasash a gurësh. Dhe atëhere çuditej me anijen e tij. Në det i dukej e vogël si... një lanxhë me motor. Këtu në kantier përkundrazi. Bile i lodhej qafa duke vështuar majën e bashit dhe gjithë trupin e anijes të vendosur mbi rulo druri, aq sa i binte dhe kapelja prej cohe kadifeje gjithë njolla boje. Atëhere Dulja rrinte e vështronte ato vajzat me pantallona të kantierit, që gërryenin ndryshkun nga fundi dhe barku i anijes. I hipte një trishtim atij, që as vetë s'e kuptonte. Atëhere atë e hante malli për det, për një lundrim sado të vogël. Gjë e keqe kur njeriu dashurohet me detin.

Eh, të ishte dhe një herë në det me atë anijen, që tani qëndronte si një bina mbi rulo druri. Të çante detin në mëngjes herët!

Kur trishtohej, Dulja ngjante me atë detin e vdekur, që buçet e duket se do të përplaset bregut me një frymëmarrje të lodhur, gjigante, të dëshpëruar. Edhe këtu mund të peshkonte, po jo... Atje ishte ndryshe. Atje do të priste peshkatarët kur të ktheheshin nga gjuetia. Do t'u thoshte fjalë të mira atyre që kishin zënë shumë peshk e do të thumbonte ata që do të vinin në molo pa asnjë kokërr. Pastaj do të hidhej në anijen që kishte peshk, do të fillonte të nxirrte ca kallamar për të peshkuar me grep, do të merrte pak sardele dhe ndonjë sinagride për ta fërguar në kuzhinën e anijes. Kurse tani duhej të vërtitej me kutinë e bojës në dorë në atë bina të ngritur mbi rulo druri.

\* \* \*

Ç'emocione ndjente Dulja kur dëgjonte atë sirenën e njohur, që i dukej se i sillte shumë të fshehta nga bota e largët. Mallëngjehej, puliste sytë gati në lot kur shihte mbi dyrek valëvitjen e flakurit me shqipen dykrerëshe dhe në oxhakun e vaporit lexonte ato gërma të njohura «CHAL». Hapte duart në majë të bashit dhe përshëndeste marinarët shqiptarë, sikur të donte t'i përqafonte të gjithë.

Kur vaporit akostohej në molo, pjesën më të madhe të kohës e kalonte me marinarët. Ndonjëherë, netve, shkonte e ulej në sallën e televizorit dhe diç shihte në atë ekranin blu me «njëqind sy». Shpesh i qëllonte të rrudhte buzët apo të ngrihej i

entuziazmuar kur shikonte në ekran vietnamezët që u jepnin grushte të njëpasnjëshme atyre jankive. I dinte të gjitha Dulja, të gjitha i dinte. Kurrë s'e ndante «Zërin...» nga vetja. Edhe kur peshkonte e mbante pranë. Në palmet kishte bërë raft librash mbushur me gazeta dhe broshura. Romane s'lexonte.

*Budallallëqe, punë që s'ngre kandar. Harxhojnë letër kot. Ndërsa duke shikuar nga broshurat thosh-te: — këto po, me këto e di njeriu ku shkon.*

Ishte mësuar t'i dallonte vaporët që nga sirenat. Nuk i thonë pak: trembëdhjetë vjet duke dëgjuar lloj-lloj sirenash. Që nga mënyra e të rënit e përcaktonte se çfarë pare ish dhe çfarë qëndrimi duhej të mbante. Njëherë Dulja u zu ngushtë kur dëgjoi një sirenë vaporit. U shtang dhe s'kishte asnjë para-ndjenjë. Kur u afruan me anije, ai vuri re pesë yje të kuqe në flamur. Buzëqeshi. Tani nuk e harron! kurrë tingullin e veçantë të asaj sirene, bile-bile edhe sikur njëqind sirena bashkë të bien ai do ta dallonte.

— Grekët po i bien kitarës tek kiçi dhe këndojnë — i tha ai djali me gisht të prerë. Dulja s'po e dëgjonte, se grepin diçka po e godiste. Kur nxori saraguan e zënë dhe e hodhi mbi kuvertë, atëhere e vuri re djalin.

— The gjë? — ju drejtua atij.

— Grekët po i bien kitarës dhe po këndojnë.

— Mirë bëjnë. Po dëgjo! Unë po dal të hedh një krikëll birrë. Ti po deshe gjuaj vetë dhe ca, po s'deshe mblidhe tonjon dhe vure në vend — i tha Dulja djalit tjetër, që rrinte përmbys filit, duke vështruar faqen e detit të murrmë nga muzgu i mbrëmjes që po binte.

I zihet fryma dhe i duket se i lidhet një nyje në grykë Dules, kur mendon se dikur do të vijë koha të dalë në pension. Ai është mësuar me këtë jetë, do gjithshka: detin, siç do dhe gruan, krikllën e birrës me të gjitha pasojat dhe nuk e ndjen si fluturojnë vitet. «Vitet fluturojnë shpejt. Si pulëbardhat mbi detin bunacë. Kridhen diku, lënë ca shkumbë mbi sipërfaqe dhe dalin për të fluturuar diku tjetër» — mendon ai.

Jetë e bukur në përgjim të sirenave. Bota e Dules kjo. Megjithatë ai do ta ketë në çdo kohë botën e tij, ndofta më të pasur. Në qoftë se nuk do t'i nxisë mendimet nën tonjon që tendoset nga goditjet e peshkut, në vjetët që do të vijnë, ai do të ketë përse të mendojë: diçka për agimet dhe muzgjet mbi det, për ndonjë projekt të djalit të tij inxhinier. Dhe gjithshka do të hyjë në botën e Dules me vrull, pa frikë. Ai do të vështrojë drejt duke bluar mendime dhe ndjenja; ashtu siç vështron tymërat që shfaqen horizontit, zmadhohen në trajtën e vaporëve, ashtu siç përgjon sirenat.

1967

## DREJT FENERIT TË NDEZUR

«Më kallmoi... po më çon korenti tutje. Tani ku do të më shpjerë? Hë, shiroko-levant, ku? E e e Avdul... edhe një herë në rrezik. O burra, bëj ballë!»

Nxinte i tëri. Vogonte i veshur me kostumin mushama dhe kapelen e rrasur në kokë. Dallgët e shtynin tutje. Mbrapa e ndiqte drita e llambës, që zbehej gjithnjë e më shumë. Nuk e kishte pompuar prej kohësh depon e benzinës. Dallgët e hidhnin përpjetë sanallin, e fundosnin dhe prapë e hidhnin përpjetë. Avduli mori kovën dhe zuri të zbrazë sanallin nga ujët. Një kovë në disa minuta. Zbrazte me nerva të tendosura...

Një krismë metalike dhe llamba humbi. Mbeti vetëm shtrati bosh mbi kic.

«Edhe ti duheshe... humbe, moj frikacake!» U kthye tek kova duke i lënë remat të lirë. Dallgët përplasheshin bankut të sanallit dhe stërkala uji mbulonin Avdulin.

«Sa e mirë ishte koha kur u nisëm në gjueti. Kishte pak punent por i lehtë. Stacioni meteorologjik detar nuk lajmëroi gjë. Qielli kishte pak re...»

mendonte Avduli. Mbushte kovën dhe e zbrazte në det duke u lëkundur nga dallgët. «I ndezëm llambat për bukuri. Ajo s'kishte peshk. Do të kishim zënë shumë. Më vjen keq... Ç'u bënë të tjerët? Vetëm jam? Arritën të gjithë feneristët të hipin në anije? Diku duhet të jetë dhe ndonjë tjetër... Po ku jam?» U ngrit më këmbë. Sanalli u batua dhe ai humbi ekulibrin. U përplas në anën tjetër të filit.

Shau me zë. Fërkoji gjurin me dorë se i dhembti. «Vetëm të jem?» — Afroi duart buri para gojës. Bërtiti. Një zë i mbytur u përhap errësirës. Përgjoi se mos dëgjonte gjë: buçimë dallgësh. Bërtiti përsëri. Era ja ktheu me fërshëllimë. Stërkala të shkumbëzuara e mbuluan. Fshiu fytyrën me pëllëmbë. I ishte rritur qimja në faqe.

«Asnjë s'më dëgjoi. Ku kanë shkuar anijet? Tani janë nisur për në Distileri. Dhe unë mbeta vetëm. Po mund të jetë dhe ndonjë tjetër si unë.» — Qeshi nën buzë. E qeshur nevrike duke shtrënguar nofullat. «Det... do të ta ha kokën dhe kësaj radhe. Jemi ndeshur dhe dy herë të tjera bashkë.»

*Atëherë kishte dalë me sanall për të mbledhur peshkun. Kishte ndezur llambën, e kishte pompuar mirë depon e benzinës dhe rrinte me nge ulur në bankë. Vonë e kishte pllakosur qjumi. Ishte përmendur nga një e përplasur dhe kishte parë që sanallë kishte marrë flakë dhe po digjej. Nuk kishte kuptuar as vetë se si kishte ndodhur. Pa të këputur tubin e benzinës dhe e kishte marrë vesh. Flaka bëhej më e madhe. Kishte mbyllur me shpejtësi rubinetin e depos së benzinës. Për drea nuk kishte me vete as kovë që ta shuante zjarrin me ujët e detit. Anija ishte larg. Shokët flinin. Edhe ata të sanalleve, që*

mblidhnin peshkun, flinin. Kishte thirrur fort, aq fort, sa s'mbante mend të kishte bërtitur ndonjëherë ashtu. Shokët e kishin dëgjuar. Motori i anijes buçiti. Ai kishte kuptuar se ishte i pamundur qëndrimi në sanall. Ishte hedhur në det. Vetëm duart i mbante në atë pjesë të sanallit që s'ishte prekur nga zjarri. Ashtu e kishin gjetur shokët. Tani ata e tregonin si anekdotë këtë. Shpesh e thumbonin për atë punën e zjarrit, që i kishte djegur sanallin.

Që nga ajo kohë nuk harronte kurrë të merrte kovë në sanall.

Hë, të kujtohet?! Herën e fundit afër Rogozhesë. Doje të më përplasje në shkëmbenj por unë arrita me forcë të hyja në gj. Po tani ku ta gjej gjirin?» Hodhi vështrimin tutje. «Errësirë — tha — shkretëti, shkretëti. Sa do të jetë ora? Qielli është i vrejtur dhe s'duket asnjë yll, ndryshe do ta përcaktoja orën». U përkul në sanall dhe mori kovën, në dorë. Zbraste ujët me forcë. Zemërimi e kishte pushtuar të tërin. Ai e dinte se duhej të ruante gjakftohtësinë. Korenti e merrte sanallin me vete. Për ku? Deri kur kështu?..

\* \* \*

«Luftë qenka kjo jetë, luftë!» U ul mbi bankon e sanallit. Asgjë s'i bënte përshtypje. I kalonin të dredhura të ftohta në trup. Çizmet i kishte të zhytura në ujët e sanallit. Kova bosh qëndronte nën të. Ai i ndjente të gjitha dhe heshtte.

«E vështirë kjo puna jonë... Ikim nga shtëpia

dhe kthehemi pas disa ditësh. Rrimë tri-katër orë dhe ikim prapë».

Ujët e sanallit po arrinte gjysmën e çizmes. Avduli u ngrit. Mori kovën dhe filloi nga puna. Shtrati i llambës herë kridhej në ujë e herë ngrihej lart.

Filluan të shkrepëtijnë rrufetë. Ndrìqonin vetëm për disa sekonda errësirën. Avduli hidhte përnjëheresh vështrimin tutje, po në vend të tokës shihte dallgët që i kërcënoheshin. Ato plaseshin sanallit, kurse ai qëndronte më këmbë dhe shikonte se si shkrepëtinte qielli. Pastaj filloi të bjerë shi. Bubullimat shkarkoheshin mbi ulërimat e dallgëve dhe të erës. Jeta dhe vdekja kacafyteshin.

«Nuk pashë gjë. Më duket se jam vetëm — ul ul sërishmi mbi bankën e sanallit. — Më mirë të jem vetëm... tani im bir fle... sikur të flija dhe unë tani... gruaja... kushedi është ngritur... ka hapur sytë në shtrat... ajo gjithnjë shqetësohet kur fryn erë... im bir fle... do ta bëj kapiten vapori... gjithë ditën luan duke bërë vapura prej letre... shokët janë të shqetësuar për mua... patjetër kanë lajmëruar ata të flotës luftarake të më kërkojnë... ata ndofta më kërkojnë... sa është ora... ku jam... sa kohë kam që ndodhem kështu?... Nja dy-tri orë të mira... ndihmë... është kohë e keqe... mundet dhe... ata të flotës luftarake... është kohë e keqe... o burra, Avdul, ti ke shpëtuar dhe dy herë të tjera... kapi remat, ku të vete... është errësirë... nuk shoh asgjë... nga është toka... asnjë dritë nuk shoh... edhe shiu duhej... ka një orë plot që po më çan veshët qielli duke gjëmuar... pushoi... he, sa mirë...»



Koha dhe deti egërsoheshin gjithnjë e më shumë.

Ai rrinte ulur mbi bankën e sanallit. I ishin mësuar veshët me uturimat e dallgëve. Lëkundjet e sanallit s'e turbullonin, por shpresat? Ato lëkundeshin si ai vetë. Në çaste të tilla më të afërta të janë mendimet. Ai mendonte dhe flište me vete. Kur është vetëm njeriu ka nevojë të dëgjojë dhe zërin e tij, mjaft të mos i duket vetja i vetmuar.

— Më ngjan vetja me të mbyturin. Edhe ai rri ca kohë mbi ujë. Kërkon me sy gjithë shpresë ndonjë trup për t'u mbajtur dhe... pastaj shkon në fund. Ku të kapem? Kjo erë dhe këto dallgë mund ta batojnë sanallin bashkë me mua...

Mori përsëri kovën në duar dhe filloi të nxjerrë ujët. E mbushte kovën kuturu, pa parë. Pastaj, duke derdhur kovën e dytë, pa errësirën e thellë.

— Ç'është ai fener atje? Tokë! Unë duhet të kem rreth tri orë në këtë gjendje. Ai është feneri i Karaburunit. Tek shpella e Haxhi Aliut nuk fryn erë. Hë, de, ç'pret, shtrëngo remat dhe përpara! E gjete trupin për t'u mbajtur!..

Era vazhdonte të frynte si e marrë. Errësira qëndronte pezull. Nuk dihej kur do të zbardhte. Nga lindja u çua një copë qielli. Hëna e gjysmuar doli midis reve. Avduli ktheu kokën dhe e pa.

— Deti do të egërsohet akoma... Do të mbajë ndonjë orë dhe pastaj do të bjerë. Kjo do të jetë orë e tmerrshme. Kurse mua më duket se s'po bëj asnjë pash përpara.

Avduli vogonte duke mbajtur sytë te feneri që ndizej dhe shuhej. Ai ishte pikësnyimi i tij. Atje tej vezullonte jeta. Ajo dritë e tërhiqte dhe ai me tërë forcat vogonte. Sanalli hidhej mbi dallgë. Bash i zhytej duke marrë çdo herë nga pak ujë. Kurse ai, me këmbët e mbështetura mirë, trupin të ngritur, përkulej dhe drejtohej. Dhe sanalli i afrohej disa metra fenerit. Edhe disa të tjera... e të tjera...

Fytyra i djersinte. Ujët e detit përzihej me djersën, dhe në buzë i dukej si shëllirë. Por ai s'mendonte për këtë. Feneri... Atje tutje shpella e Haxhi Aliut. Atje s'frynte erë... Deti është krejt bunacë.

— Hë, det, qysh të dukem!

*Anija e tyre po shkonte në Durrës të bënte remontin kapital. Rrugës ishin takuar me një anije tjetër. Ishin takuar aq afër, sa ishin përplasur keq dhe anija e tyre ishte çarë. Po futej shumë ujë. Ai po mbushte sallën e motorit, palmetet dhe gjithë fundin. Mbytja e tyre ishte e pashmangshme. Anija tjetër nuk kishte pësuar gjë. Domosdo: druri s'mund ta hajë me hekurin.*

*I kishin këputur shpresat për shpëtimin e anijes. Kishin filluar të hidhnin plaçkat dhe gjërat më të domosdoshme në anijen tjetër. Koha nuk priste. Disa nuk merrnin asgjë dhe hidheshin në anijen tjetër. Ai nuk kishte harruar të merrte dhe shishen e vajit, të cilin e përdorte për të pastuar pushkën.*

U dëgjua një kërcitje e lehtë si e një dërrase të thyer. Avdulit i mbeti gjysma e remit në dorë.

Gjysma tjetër humbi në errësirën e dallgëve. Ai mori në duar remin e thyer dhe e pa.

— Kalbësirë! — mërmëriti tërë inat. E flaku tutje dhe gjysmën tjetër. — Ku vajti e u thye tani, s'më kanë mbetur as njëqind metra për të arritur.

Hapësira e çarë midis reve po zgjerohej. Hëna ndrinte në të. Retë i kërcënoheshin por ajo s'pyeste syresh, ndrinte e ndrinte. Korenti i erës e shtynte përpara sanallin.

«Ta lë sanallin të lirë në rrymën e korentit. Me remin e vetëm ta pres drejtimin djathtas. Vësh-tirë do ta kem. Pa u munduar asgjë s'bëhet. Po më lënë edhe forcat. Feneri tani ndriçoi më pranë. Du-het të kem kujdes ta pres mirë sanallin në drejtimin e shpellës, ndryshe dallga do të më përplasë në shkëmb». E vendosi remin në anën e djathtë. E ngriti lart dhe e afroi tek sytë. Cima qenka dobësuar — tha me vete, — po nuk mbajti do ta kem të vësh-tirë, se korenti do të më shtyjë përpara larg shpe-llës. Ndofta do të më përplasë në ndonjë shkëmb. Sa t'i lidh cimën e re largohem... Vogo, vogo, Avdul, provoje njëherë!»

Era e shtynte sanallin përpara. Avduli hera-he-rës i jepte remit të djathtë. E la remin të lirë dhe përgjonte. Feneri dukej afër. Avduli i shikonte dhe skeletin, kur ai ndizej. Shkëmbi binte thikë mbi det. Dallgët përplaseshin me tërbim mbi të.

Era sillte së largu ulërimën e një sirene. Avduli përgjonte me veshë ngritur. Ulërima u përsërit. Një fashë e bardhë drite rrëshqiti nga errësira e ra mbi faqen e rrudhur e të zbardhur të detit. Drita e pro-zhektorit ndriçoi kurrizin e murrinë të Sazanit. U

end mbi det dhe ndriçoi sanallin e Avdulit. Ai vuri pëllëmbën mbi fytyrë.

— Më verbove, more! — pastaj i kënaqur tha me vete — gjuajtësi! Shokët kanë lajmëruar për mua dhe ai ndoshta më kërkon. Është rrezik të rri e ta pres sa të vijë. Fenerin e paskam lënë prapa. Tani duhet të pres drejt e te shpella.

Mblodhi të gjitha forcat dhe nisi të vogojë. Drita e prozhektorit i ndriçonte shpatullat. Lindja po fillonte të zbardhte. Nga Karaburunë era sillte cicërimat e para të zogjve. U dëgjua zëri i përvajshëm i një guguftuje. Tri pulëbardha po i vinin rrotull sanallit.

«Po bëj dhjetë orë që s'kam futur gjë në gojë... Më shumë. Kam uri... Ushqimet do më jenë lagur të gjitha... Ja dhe shpella. Këtu era nuk rreh më!..»

Ju afrua shpellës dhe zbriti në një shkëmb. Lidhi atje cimën e sanallit. Pastaj u hodh në të dhe zuri të vogojë në drejtim të kundërt. Ju afrua një shkëmbi që binte thikë në det. Lidhi atje anën tjetër të cimës. U hodh sërishmi në sanall dhe zuri të tërheqë cimën. Pastaj e lidhi te banka. Sanalli qëndronte i mbërthyer mes dy shkëmbenjve. Lurahatej nga pak hera-herë. Avduli u ul në majë të bashit. Nisi të qeshë me vete.

\* \* \*

Drita e mëngjezit zboi errësirën. Gjithshka dukej qartë. Tutje gjiut deti dukej se po binte. Era nuk fishkëllente më me tërbim, por dallgët ende shkumbëzonin. Tek shpella bunacë. Ujët ishte i qetë

dhe i kristaltë. Në thellësi nxinin shkëmbenj dhe barishte. Peshq të vegjël notonin rrotull tyre. Një rufjo i madh u shfaq nga thellësia. Gllabëroi një peshk të vogël. Të tjerët u zhdukën.

«Të kisha parangallin me vete — mendoj Avduli duke parë rufjonë që notonte rrotull sanallit. — Bëhet një supë me kokën e tij që ç'ke me të.»

U ngrit më këmbë. U shtriq me bërrylat e hapur anësh dhe pëllëmbët prapa kokës. Pastaj ndënjë ashtu më këmbë dhe shikonte në ujë.

«Shpëtova dhe kësaj radhe. Unë gjithnjë do të ta ha kokën ty, det! A-a-a, ja, i qetë dukesh!» — U kthye nga shpella. Nuk ishte as dhjetë metra larg saj. — «Kam uri... kam uri, o Haxhi Ali!»

Mori torbën, që e kishte vënë nën bash të sanallit. Ajo kullonte nga ujët. E hapi. Buka ishte bërë qull. I nevrikosur e flaku nga shpella.

— Merre, o lumëmadh, se plaçkite tërë jetën për të tjerët dhe vdiqe për një copë bukë. Na, ngopu! — Buka po zhytej ngadalë në ujë. Disa saragojë të vegjël filluan ta çukisnin. U bë pjesëtar dhe një peshk i madh dhe buka humbi në thellësi.

Zuri të hajë nja dy presh që i kishin mbetur në trastë. Ushqimet e tjera i hodhi në det. Frëmoi në xhepin e brendshëm të xhaketës dhe nxori qesënë e duhanit. Drodhi një duhan dhe e ndezi me çakmak. Cigarja e hidhëroi.

— S'piket duhani pa ngrënë! — tha dhe pësh-tyu në det. Batanijet që kishte marrë me vete kur doli për të mbledhur peshkun i ishin lagur. Mberdhite. Dridhej nga pak por ndjehej i qetë. Afër u dëgjua një sirenë, pastaj u shfaq para tij gjuajtësi. Avduli u ngrit më këmbë dhe përsëndeti me duar

marinarët. Nga gjuajtësi lëshuan një sanall. E morën Avdulin. Sanallin e tij e tërhoqën prapa kështu të lidhur me cimë. Kapiteni i gjuajtësit e përshëndeti dhe e rroku në qafë.

— Shpëtova mirë! — tha Avduli kur e çuan në dhomën e kapitenit.

Dhe tregoi si i kishte ndodhur...

1964

## SEKRETI PËR TË QENË DIELL

— De, moj pikë e zezë, deeee! Pleqëri dhe verbëri bashkë.

Pas tetëmbëdhjetë vjet pune në minierë ju veshën sytë dhe nuk shikonte mirë. «Duhet të shtrohesh në spital» i thanë. Dy muaj e gjysmë net njezet e katër-orëshe në errësi të plotë me sy të fashuar. Dy muaj e gjysmë në ato salla të bardha që s'i pa kurrë. Rezultati: mbeti në errësi. Nga syri i djathtë turbullirë. I majti shkoi e vate për gjithnjë. E nxorën në komision medikolegal. I dhanë një raport me afat derisa të dilte në pension. Nuk ishin shumë: katër muaj; në javë gjashtëmbëdhjetë, në ditë... Pa le që ai mendonte ta shtynte edhe ca kohë afatin e daljes në pension.

— Më latë në baltë në pleqëri, o sy. Do më shihnin sa do punoja. Pikë e zezë deee!

\* \* \*

Nga lufta mbeti i pacënuar. — Dy-tri plagë por pa rëndësi. I ra Shqipërisë pash më pash më këmbë. Luftoi, vrau shumë italianë, «dedesko» dhe

ballistë. Plagosej, shërohej dhe prapë marshonte me brigadën. Deri në Pejë e Mitrovicë vajti.

U kthye nga lufta me atë gëzimin popullor që kishte shpërthyer në të gjithë vendin. Shqipëria ishte çliruar.

I dhanë dy javë leje të çlodhej, të çmallej me familjen dhe fshatin. Do ta lajmëronin se ku do të punonte.

Fshati ishte i rrënuar nga lufta. Shtëpitë të djegura, të nxira nga tymërat dhe bloza. Në një kohë tjetër do të ndjente trishtim duke vështruar ato bina që rënkonin nga pesha e rëndë e gurëve mbi trarë, nga ngjyra e zezë e mureve pas zjarreve. Kishte dëgjuar shumë nga ai komisari që ju vra diku në afërsi të Pejës. Ç'gjuhëbilbil që ishte! Kur fliste ai, me mend ngrije fabrika, shkolla, pallate, rrugë të drejta e të bukura. Ç'nuk të shihnin sytë, kur fliste ai!

Në mal mësoi të ëndërronte për të ardhmen.

Atëhere ishte pranvera e parë që kalonte fshati në liri. Pemët sapo kishin çelur sythet. Toka lëshonte afshe të ngrohta. Bari ngrinte kokën rëpër arat dhe ledhet. Mëngjezin e parë ai doli në fshat. Fshati i ngjau si një plakë e lodhur.

«Do të të përtërijmë... Do të të bëjmë nuse...» mendoj ai.

Mëngjezin tjetër ai doli të punonte tokën e tij. Në të ardhmen do të kishin shumë tokë që donte të punohej. Të varfërit kishin ëndërruar aq shumë për atë tokë. Kishin derdhur plumba mbi trupa amiqsh për atë tokë.

Gjithshka ngrohej e djersinte. Ai i ndryste damarët dhe toka shkrifej nga kënaqësia. Punoi shu-



më. Duart ju skuqën e ju bënë me flluska. Kur dielli ishte ngjitur disa hostenë lart, e ëma i sollti mëngjezin aty në tokën e zezë e të thërrmuar.

— Biro... të kam parë në ëndërr.

— Si më ke parë, hipur mbi kalin e beut?

— Korba... më rruash me fëmijë! Të kam parë të varur mbi një tel dhe poshtë teje kalonte një lumë. — Ai kishte qeshur. Kohët e fundit qeshte shumë. Qeshte dhe vrëhej. Kur vrëhej, ngjante si një qiell i mbyllur që donte të shkrepëtinte.

Pas dy javësh i erdhi një letër me korrierin e fshatit. Lufta do të ishte më e madhe. Në mal kishin luajtur me trimëri vetëm këmbëzën. Tani duhej trimëria e këmbëzës, e krahëve dhe e trurit. Hë për hë në një minierë si punëtor.

Pa lerë dielli u nis më këmbë nga fshati. Arriti në vendin e minierës më të ngrysur. Priste të shikonte diçka të ndërtuar. Ndonjë bina të paktën, por hiç. Në një faqe mali ca kasolle vllhësh. Në fushë driza dhe shkurre. Cërcërima zogjsh.

«As derri s'i çan dot» mendoi.

E kaloi atë natë pranë një zjarri, me grupin e punëtorëve që kishin ardhur të parët. E nesërmja nuk i zgjoi asgjë të veçantë. Dinte që qymyrgurin e kësaj miniere e kishin shfrytëzuar italianët për një farë kohe. Për vendin s'dinte asgjë. Pyeti ku ishte miniera. I treguan ca zgavra që dukeshin në një faqe mali. Pyeti se nga kalohej për atje. I treguan një tel të varur mbi lumë dhe një kosh hekuri në të.

— Mbahu fort dhe mos shiko poshtë lumin. Të merren mendtë, dëgjon? — dhe pllump në fund.  
U zvarris me atë kosh të varur në tel. Poshtë

lumi vazhdonte rrugën e zhurmshme dhe gërryese. Kujtoi nënën, ëndrrën e saj dhe shumë gjëra të tjera.

\* \* \*

— Luftuam kaq shumë, punuam kaq shumë dhe të mos shohësh asgjë? Dej, moj pikë e zezë, deee!

Në avllinë përpara shtëpisë kishte një kopësht të vogël. Ai i donte shumë lulet. Kur ndjeu që po plakej, filloi t'i donte edhe më shumë. Edhe lepujt i donte shumë. Çdo mëngjez ngrihej pa lerë dielli. Ai thoshte se është mirë që njeriu të ngrihet pa lerë dielli. Ujiste a prashiste lulet. I përkëdhelte me dorë. Ndjente si zhvilloheshin e çelnin sythet. Gëzohej kur çelte gonxhja, merrte jetë e zbukurohej. Dëshpërohej kur petalet zinin e binin të vyshkura e të zverdhura.

Lepujt, megjithëse i donte shumë, nuk i linte të bredhërinin në avllinë e luleve.

Çdo mëngjez i vinte nipçja nga blloku tjetër i apartamenteve. I zgjaste faqen dhe ai ja puthte.

— Gjysh, dhjetë do marr po më ngriti.

Ai i jepte lule për veten dhe mësuesen, dhe nipçja ikte i gëzuar për në shkollë. E ndiqte me sy gjersa largohej. As vetë s'e kuptonte përse pshe-rëtinte më nge dhe kthehej në punën e luleve. Punonte me hamendjen e atij që sapo është verbuar dhe diç shikon turbullt me syrin e djathtë, kur është afër objekteve.

Kur mblihdeshin në shtëpi, ata bëheshin një familje e madhe. Djem e çupa, nipër e mbesa. Mbushej shtëpia e gjëmonte nga muhabetet. Pa fillonin bisedat që nga nëntoka, tek mekanika, arësimi e

deri tek satelitët që ngriheshin për në hënë. Ai hapte veshët dhe dëgjonte. Po kur ai djali i madh, minatori, ankohej për punën, vështirësitë, kthehej i tëri nga ai dhe s'e përmbante veten.

— Dëgjon?... I kemi ngritur shinat në krahë që nga ura e Tepelenës e deri në galeri. Maqineritë na dilnin të prishura e i kthenim prapë. Ishin kohë trubullirash, sabotimesh. Lëndën e drurit e prisnim tek kodrat e Karaules dhe e mbartnim në krahë. Provuam dhe dy kuaj për të tërhequr vagonat në galeri, po s'qëndruan as dy javë se hidhnin vickla. Kështu biro. dëgjon!

— Mirë baba, mirë... I kemi dëgjuar.

— Jo po t'i dëgjosh mirë...

\* \* \*

Sapo ngrihej, nxirrte zorrën e ujit, e vinte tek çesma dhe fillonte të ujiste lulet. Punonte me hamendje. Nuk shikonte asgjë nga ato që rriste dhe zbukuronte me duart e tij të argasura galerive. Fqinjët i thoshin se kishte duar të arta, se kishte goxha lule në kopësht. Ai kënaqej, buzëqeshte dhe prapë psherëtinte më nge. Dimri ishte i mërziqshëm dhe i plogët për të. Atëhere i duhej të merrej vetëm me lepujt.

Në lulishten e pensionistëve rrallë shkonte. Pa le që kohët e fundit edhe atje s'gjeje njeri.

\* \* \*

Ndonjëherë atë e pllakoste një dëshpërim i thellë. Në raste të tilla disa qajnë, disa pinë, disa...

Ai shante me vete, bile... ndyrë. As vetë s'e dinte se kë, por shante për ç't'i vinte. De, moj pikë e zezë, deee!

Atëhere ai kujtonte shumë gjëra. Donte t'i thoshte nipçes. «Dëgjon nipçe?! Atëhere kur prisnim atë autokolonën gjermane në të dy anët e rrugës... atëhere...»

Partizanët e thërrisnin të gjithë mitraljeri Vajt. Kishte një mitraloz «Shartz» nga ata që të korrnin. Ai dinte të kornte për bukuri. Atëhere ishte gusht... Vapë. Gjinkallat çuçurinin për hesap të tyre. Prisinin nën atë diell gushti. Ishin fshehur pas shkëmbenjve në dy anët e rrugës. Autokolona gjermane kaloi aty nga dreka dhe u ndez lufta. As vetë nuk e kuptonte mitraljeri Vajt përse këndonte bashkë me «Shartzin». Këngët ishin nga ato partizanet të kënduara pushimeve. A i përtypte fjalët dhe meloditë copa-copa, si për të shuar etjen e për të njomur buzët e çara.

— Dëgjon nipçe?... Gjashtë orë luftë... Vapa të shkrinte si gjalpë. U dëgjua ajo jona «Para partizanë!» Unë shkova tek një maqinë kur lufta kishte mbaruar. Dëgjon, nipçe!.. tek një maqinë. E vështrova i çakërdisur. Kabinën dhe serbatorin. Serbatorin dhe kabinën. Në kabinë një oficer gjerman i përgjakur tek koka. Dëgjon nipçe... Kur ke etje, të vishen sytë me mjegull të çakërdisen. Ju afrova oficerit dhe i vura revolverin në kokë. «Na, qenbirqeni!.. Vjen nga ana e anës të na vrasësh dhe të na lësh pa ujë... Merre... Ikë në hale të sat' ëme tani!» Ja zbraza gjysmën e plumbave.

Isha bërë bishë, nipçee! Të kisha fuqi, edhe maqinën do ta kisha përmbysur. Ai oficeri që i futa

plumbat në kokë kishte një pagure. Etje... nipçe!  
Ja hoqa nga brezi. Biri i bushtrës pinte dhe verë.

Ktheva një glënkë të madhe dhe kusurin e ruajta për shokët.

Ai dinte ta mbyste dëshpërimin me kujtime. Ato ishin jeta e tij. Ato depërtonin në errësirën e dëshpërimit si copëza dielli. Errësira ndriçohej dhe atë e pushtonte entuziazmi, dëshira për të punuar dhe jetuar. Duhet të punosh e të jetosh shumë për të krijuar copëza të tilla dielli. Ato ai i bashkonte në një diell të madh. Nganjëherë atij i dukej se ishte diell, se diçka ndriçonte në brendësinë e botës së vet. Dhe këtë ai e quante sekret. Këtë sekret ja tregonte vetëm nipçes.

\* \* \*

Cdo punë e re në fillim është e vështirë.

Ai ishte marrë me tokën që në moshë të re. Pastaj me «Shartzin». Pas luftës ju desh të merrej me nëntokën. Mbitokën e njihte mirë. Për nëntokën kishte dëgjuar. Pastaj e njohu edhe atë mirë. Dikur, kur shikonte hënën e krahasonte me llambat e karbitit. Në fillim kishin pak llamba karbiti. Më vonë më shumë, derisa i kishin zëvendësuar me bateri. Tani, kur kujton hënën, kujton llambat prej karbiti dhe anasjelltas.

Atyre ju desh të depërtonin nëntokës thellë me kollitjet e zeza të herëpashershme. Nga mungesa e ventilatorëve ishin gjithmonë të etur për ajër. Në prakun e verbërisë së tij motokompresorët gjëmonin nëpër rrugët dhe monopetet e nëntokës. Kishin kaluar kohë të vështira në shfrytëzimin e nëntokës. Ai s'mund të harronte asgjë nga ajo kohë.

Oraret e shkëmbimit të turneve i dinte mirë. Në kohën e tij kalonin lumin me teleferik për të hyrë në galeri. Ai e dinte se kohët e fundit kishin ardhur autobusa, që mbartnin punëtorët në të tri turnet. Edhe vetë kishte vajtur e kishte ardhur me ta. Ashtu kot, sa për të qenë midis shokëve të punës.

Shkonte në çdo kohë në vendin e autobusave. Stacioni ishte pranë një barrake të vjetër. Dikur kishte qenë ambulancë dhe më vonë shkollë. Ishin ndërtuar pallate, shkolla, shtëpi të reja, ishin asfaltuar rrugë, kurse ajo barrakë kishte mbetur aty pranë stacionit si dëshmi e një kohe të kaluar.

Ai dilte në rrugë pasi mbaronte së ujituri a së prashituri lulet. Shpesh drejtohej nga stacioni. Qytetin e njihnte me pëllëmbë. Ecte me një shkop, të cilin e trokiste trotuareve e asfalteve. Të gjithë e përshëndesnin. E dinin se ku do të shkonte. Ndonjëri mendonte: «Edhe ky s'po gjen karar. Sikur rrugët, stacioni, miniera, s'bëjnë dot pa të. Rri e ngrys ditët që të kanë mbetur, a derëbardhë!»

Ai e dinte që në thellësinë e galerive ishin shokët e tij të punës, që vërtiteshin nëpër damarët e qymyrit për ta nxjerrë atë mbi tokë. Mbante mend se tek kthesa e galerisë numër 5 e kishin patur gjithmonë pisk me shinat dhe u rrëzoheshin vagonat.

«Pa çka, pa çka... djemtë s'do t'i kenë lënë shinat ashtu si kanë qenë. Diç do të kenë bërë me to. Të pyes njëherë».

— Xha Vait... Vagonat tani i tërheq elektrovozi deri tek ashensori. Smnat janë për bukuri.

— Dreq... xha! — I shponte në gjoks kur i thërrisnin ashtu. Xha... domethënë i pafuqishëm, i

paaftë për të punuar në minierë — I tërheqka clek-trovozi!.. Ç'të ishte vallë ky elektrovozi?

— Elektrovozi është një motor i vogël... si tren, xha Vait. — Prapë ai të shpuarit në gjoks. — Ke parë tren? — Si s'kishte parë tren! Ç'pyetje! Me tren ai kishte udhëtuar atëhere kur kishin inauguruar hekurudhën e parë. Kishte parë dhe Enver Hoxhën kur kishte prerë shiritin.

Autobusi vinte gjithmonë i zhurmshëm, me fragmente të këngës labe. Zbrisnin minatorët dhe e vinin në mes. Ato ishin castet më të lumtura për të. Atëhere atij i dukej se shikonte çdo gjë: elektrovo-zët, që përshkonin shinat e nëntokës dhe shokët që gërmonin qymyrin në llavë.

Ata që e kishin vënë në mes i tregonin për nivelin e tretë që po mbaronte së betonuari dhe së shpejti do të fillonte të shfrytëzohej.

Në qenjen e tij ndizej dielli, të cilin ai e mbante sekret.

Sapo të ndahej prej tyre, do të nxitonte t'ja tregonte nipçes.

1969

## ATË VERË KUR FILLOI GARBIA

— Dëgjo këtu ti — i thashë — mua të mos me bërtasësh tjetër herë, merr vesh! Të tjerëve çirrju deri në kupë të qiellit, por unë nuk të lejoj të më bërtasësh. Dëgjoj edhe pa më bërtitur.

Na kishte zënë një garbi e poshtër dhe mezi e çakostuam anijen nga molo. Tani ne ishim në det të hapur, jashtë çdo rreziku. Prisnim të vinte ekui-pazhi dhe të shkonim diku për t'u strehuar nga ajo garbia e poshtër. Bënim rrathë të shkurtër në atë detin me dallgë që të merrte mendjen. Isha bërë shpuzë dhe më kishte kërcyer ai damari im i keq, që më qëllon më të rrallë në kokë.

Qëndroja tek dera e timonerisë gjithë nevrrik.

— Mos do të të përkëdhel bishtin e të të flas me delikatesë? — Edhe kapedani ishte inatosur por i duhej të qëndronte mbi timon.

— Dëgjo, kapedan. Unë nuk dua asgjë... vetëm mos më bërtit, se nuk duroj dot, — thashë.

Ai më tha se më dinte për djalë të mirë dhe të urtë. Unë i thashë se nuk doja të më bërtisnin pi-



kërisht sepse isha djalë i mirë dhe i urtë. Ai më kujtoi se më kishte bërë nder duke më paguar si peshkatar; i parë. Kishte ndërhyrë vetë për këtë dhe tani nuk ja dija. Unë e falënderova dhe i thashë të më paguanin për aq sa meritoja por vetëm mos të më bërtiste njeri.

S'të linte një minutë të qetë! E doja dreqin. E donim të gjithë, por shpesh ta bënte borxh dhe kohët e fundit, nëpër palmet peshkatarët kishin zënë të pëshpërisnin për të.

Ishte kohë e mirë, djalli ta marrë! Ajo garbia erdhi papritur. Deti vetëtinte si qelq dhe s'kishte asnjë rrudhë. Unë isha caktuar dezhur në anije atë ditë. Sapo isha zgjuar nga gjumi dhe kishte dalë mbi kuvertë. Në molo gumëzhinin dhe të çanin veshët ata vinqat e atij vaporet që kishte ardhur disa ditë më parë. Vaporit ngarkonte fuçi bitumi, andaj në çdo kohë vinin «Skoda» dhe zetorë, që shkarkoheshin nga vinqat e vaporet. U shtriqua nja dy herë dhe u hodha në molo. U ula në një kalun dhe vështroja nga vaporit. Në vapor ishte një biondinkë e bukur me flokët bishtkali. Ajo dilte shpesh mbi pupen e mbuluar nga një fletë çadre; ulej në një shezlong dhe diç lexonte në një libër. Unë e dija që në disa vapore mbanin femra si radiste dhe kameriere. Kisha dëgjuar bile që, rrallëherë qëllonte të ishin të bukura. Ajo biondinka me bishtkali nuk dukej si ato. Ajo ishte shumë e re për të qenë si ato. Ajo ishte shumë e bukur për të qenë si ato. Thoshin se mund të ishte e bija e kapitenit.

Mendoja për shumë gjëra. Vështroja atë dhe e krahasoja me Inën time. Ina ishte më pak e bukur, por më e kapshme se kjo. Isha i dashuruar.

Në këtë kohë filloj garbia. Nuk e kisha mendjen. Anija përplasej lehtë në këmbët e molit.

— Eeej ç'bën... paske qenë gomar... Nuk shikon se ç'bëhet? — më thirri kapiteni.

Ai ishte hedhur menjëherë në anije dhe kishte filluar të zgjidhte cimat. U hodha dhe unë në anije me shpejtësi. I thirra motoristit që flinte. Ai u zgjua dhe ndezi motorin. Luftuam shumë, derisa çakos-tuam anijen. Unë isha përplasur pas filit të anijes. Kisha gërvishur barkun. Vonë e mora vesh që kisha gërvishur barkun.

\* \* \*

Të krijohej përshtypja se ishim vetëm ne të dy në anije. Po të mos dëgjonim motorët që rrapëllinin me zhurmë, nuk do të dyshonim se ishim vetëm ne të dy. Motoristi nuk dukej i gjallë. Ai s'merrte vesh se ç'bëhej. Dinte se kishte filluar një garbi e fortë dhe për këtë kishte ndezur motorin. Qëndronte në kabinën e motorëve.

Ç'dallgë dhe ç'marramendje! Të dukej se një qenje me kthetra të lloçkaviste në stomak.

Qëndronim të dy në timoneri. Unë tek shkallët e hyrjes, ai mbi timon. Dallgët vinin varg-varg si kuaj të bardhë; shkrofëtinin e nxirrnin shkumë duke e hedhur anijen sa nga njëri krah në tjetrin.

Ai dukej i menduar dhe nervoz. Unë isha vetëm nervoz.

— Lodhet njeriu... i bie bretku e shuhet në punë... dhe një qurravec i thotë që të mos i çirret,

— Mos më thuaj qurravec!

— Ti je akoma në shpërgajtë e detit... unë u rrita në det. — E dija këtë.

— S'paskam të drejtë të bërtas, se zotëria e tij qurravec patakset pas një çupke.

— Po e tepron — i thashë.

— Mbylle!

— Ja ku po ta them prapë se po e tepëron. — Më kishin zbritur ca dhe po më vinte keq për të. E doja kapedanin tim. Mirë e tha: unë isha akoma në shpërgajtë e detit. Ai kishte hyrë në det që pesëmbëdhjetë vjeç. Ishte punëtor kapedani im. Ai dukej si një copë hekur, si një mballomë e domosdoshme për anijen. Ai nuk e dinte që ishte mballomë. Nuk kishte thënë ndonjëherë që ishte mballomë. Bile do të zemërohej po të dinte që unë mendoja se ishte si një copë mballomë për anijen.

Peshkatarët thoshin se ne ishim anije me fat. Edhe kur të tjerët vinin bosh në molo, ne nuk ktheheshim pa gjë. Ata thoshin se ishim me fat. Edhe për mua thoshin se kisha sjellë fat në atë anije. Që kur kisha shkuar unë, ne kapnim vazhdimisht. Kapedani i dinte të gjitha shtigjet e peshkut. E nuhaste lëvizjen e tij në stinët. E përcaktonte që nga rryma dhe ngrohtësia e ujit se ç'lëvizje bënte. Dhe i dilte në pritë. Pritat e tij ishin të mbara dhe sillnin peshk!

— Qurravec... ti nuk ke dalë nga shpërgajtë e detit akoma.

— Unë nuk jam qurravec por nuk duroj të më bërtasin, — thashë.

Më dukej vetja pulë.

Ne atëhere gjuanim me trata kiçi. Kishim ikur larg, përtej Sazanit dhe na zuri në befasi ai cikloni i fortë, që fryu në fillim të pranverës së kaluar. E tmerrshme! Tym i bardhë stërkalash. Era frynte si e çmendur. Nga çasti në çast dukej se do të na ngrinte pëshë mbi ujë dhe diku do të na vërviste. Direku lëkundej, kërciste e dukej se do të thyhej. Ju afruam 50 metra Sazanit e nuk futeshim dot në port. Pastaj era na përllau dhe na vuri në revan. Na shtynte në drejtim të Durrësit.

Kapedani im dukej gjakftohët.

Ishim lodhur të gjithë. Disa ishin struktur në palmet e po nxirrnin zorrët nga të vjellat. Cikloni të tillë ata s'kishin parë ndonjëherë. Edhe kapedani thoshte se nuk kishte parë ndonjëherë. Qëndruam tri-katër orë në det të hapur. U troshitëm e u bëmë si mos më keq. Kapedani manovroi dhe mundi të hyjë në gji nga mezokanali. Lundronim rrëzë Karaburunit. Erë e përbindshme. Copëra gurësh, pemë të thyera fluturonin e humbisnin në detin e çmendur.

Në strehim mbërritëm natën vonë. Shokët e tjerë kishin shkuar prej kohësh. Nga cikloni na ishin thyer timonët e tratës. Ne ramë në gjumë si të vdekur sapo akostuam anijen në strehim.

\* \* \*

— Unë e di ç'mendoni ju për mua. Di bile se keni filluar të pëshpërisni lart e poshtë, — tha kapedani.

— I ke rënë në të, — ju përgjegja.

— I kam rënë në të dhe s'e lot as topi. Po ju akoma nuk ma keni thënë me zë të lartë atë që mendoni.

— Nuk kemi frikë të ta themi...

Isha ulur mbi shkallën e parë të timonerisë dhe po vështroja nga bregu. Andej ishte rrëmujë dhe dukej vetëm re pluhuri. Midis pluhurit dukeshin copa apartamentesh dhe pemësh. Vetëm ato dukeshin. Kalimtarët dalloheshin si pika të zeza. Vështrova antenën e madhe në atë vaporin ku ishte ajo biondinka; anijet tregëtare, ku hynin e dilnin mbartës që ngarkoheshin e shkarkoheshin diku në zëtorë. Pashë peshkarrëxhet e tjera që bënin po ata rrathtë në atë det të poshtër dhe e ndjeva veten më mirë se ç'isha. Gjithmonë njeriu e ndjen veten ndryshe nga ç'ka qenë. Unë e ndjeva veten më mirë se ç'isha.

— Atë që e mendon do të ta themi. Nuk kemi frikë të ta themi. — I thashë atij burrit që vërtiste timonin dhe që ishte kapedani im.

— Dua të ma thoni... qurravec!

— Nuk është mirë të tepërohen gjërat, — thashë. Nuk ma vari për atë që thashë.

Vajta dhe u ula në një stol që e kemi vënë në pjesën e bashit. Bashi ngrihej dhe ulej me rrëmbim. Më dukej se ngriheshim në lartësi dhe nuk binim poshtë. E ndjeja veten pezull. Edhe të brendshmet i ndjeja pezull. E dija se po të qëndroja akoma atje do të villja. Isha shumë i ngopur dhe gjithshka e brendshme më dukej e rëndë. A e dini atë dëshpërimin që të pllakos pasi të ka rënë nevrniku dhe kupton se dikujt i ke rënë në qafë mëkot?

Vështrova andej nga ishte punishtja e rrjetave dhe nuk pashë gjë veç një grumbulli çatiash përmes një reje rëre. Mendova për Inën. Pastaj për kapedanin... Për Inën... për kapedanin... për... kuptova se po më përzihej dhe shkova u futa në

palmet. Nuk e ndjeva veten mirë as në palmet. Hekuri ishte ngrohur nga dielli dhe atje brenda të zihej fryma. Rash përmbys mbi krevat dhe po tundesha si në një kolovajzë.

— Kapedani ka ca kohë është bërë i padu-rueshëm.

— Lëre...

— E pe sot... nuk i tha asnjërit që do të tërhiqte kavot e vinçit në magazinë. I tërhoqi dhe i sollti vetë në anije. Pastaj zuri të çirrej se po i binte bretku, se ne ishim vetëm për të vajtur tek fustanet e grave.

— Lëre, se e dëgjova.

— Zuri të mbrëthente kavon e re dhe s'na linte të vinim dorë në të.

— Nuk bëjmë mirë që flasim kështu.

— E di që duhet t'ja themi, por mos nuk na dëgjon.

— Duhet ta provojmë.

— Ke vënë re kur dalim në gjueti? Ai nuk pyet fare se ku do ta bëjmë rrethimin.

— Gabim e ka... ne e dimë që ai është me eksperiencë, por mirë është të na pyesë edhe ne. Kemi kaq vite në det.

— Bërtet shumë.

— Kur duhet, mirë bën.

— Bërtet shumë.

— Duhet t'ja themi.

— Duhet t'ja themi...

\* \* \*

Kapedani ishte njeri i heshtur përgjithësisht. Fliste pak dhe mendonte vazhdimisht. Kuvendonte

me hope. Kur nevríkosej, bëhej shumë i egër dhe këpuste gjithfarë fjalësh nga goja. Ne ishim mësuar me të. E dinim që ai shpesh pinte raki. Kur fillonte të pinte nuk mendonte më për t'u ngritur nga tavolina. Ne i flisnim gjithnjë për këtë. Bile një herë e bëmë problem dhe në mbledhjen e kolektivit. Na premtoi se nuk do të pinte më, por prapë, më të rrallë, në këmbë, tek banaku, duke përgjuar se mos hynte ndonjë i njohur, e kthente ndonjë gotë.

Ky zakon i mbeti që atëhere kur i vdiq gruaja.

E kishte dashur shumë gruan.

Kohët e fundit ajo ishte dobësuar dhe ishte vazhdimisht e sëmurë. Lajmin e vdekjes ja kishte sjellë një kushëri i largët i tij në një copë pusullë. Nuk kishte guxuar t'i thoshte asnjë fjalë më tepër. Vetëm pusullën i kishte dhënë. Kapedani nuk kishte vazhduar më tej atij rreshtit ku thuhet se gruaja e tij...

Ç'ishte kështu! Kishte ndërë në hundë afshin e rakisë. Kishte shkuar në pijetoren e parë dhe kishte rrëmbyer nga banaku një shishe raki. E kishte shkundur paq aty në këmbë, para banakut. Kusurin në breg të detit.

Që nga ajo kohë i kishte mbetur zakon të pirët.

\* \* \*

Shokët e ekuipazhit kishin ardhur në anije me një sanall.

Ne lundronim në drejtim të Rogozhesë, andej nga ishin ato dy bovat e ndryshkura dhe një fuçi cisterne për të mbajtur ujë të pijshëm.

Kapedani ishte tërbuar dhe i dridheshin duart kur mbante timonin. Dallgët vinin të mëdha, e shtynin anijen, e hidhnin mbi kurriz dhe e lëshonin poshtë pa mëshirë. Ajo tundej në treso fil më fil. Ujët po hynte edhe në palmetë. Peshkatarët shikonin andej nga ishte timoneria, rrudhnin buzët dhe nuk kuptonin përse kapedani po e drejtonte aq keq anijen. Dikush shkoi dhe i tha kapedanit, që t'ja jepte atij timonin. Ai i kishte shfryrë, i kishte thënë se ishte i poshtër, njeri që shante prapa krahësh dhe s'ta thosh copë mendimin në sy.

— Thuaje pa frikë dhe mos çuqurit si ato laureshat vesh më vesh — thërriste kapedani. Ai që kishte kërkuar të mbante timonin kishte ngritur supet nga habia dhe s'e kishte bërë të gjatë.

Kapedani nxori kokën nga kabina dhe thirri:

— Dëgjoni ju të kiçit... meqë jemi të gjithë, sapo të mbërrimë në strehim do të bëjmë mbledhjen e barkës.

Unë akoma nuk e ndjeja veten mirë. Isha ligështuar dhe shokët më thoshin se isha zverdhur si limua. Gjë e poshtër kur të zë deti! Nuk gjen qetësi asnjë minutë dhe ëndërron tokën. Por ajo të duket e largët, shekuj e largët.

Mos të zëntë ndonjëherë deti!

Edhe Ina të duket e largët kur të zë deti.

\* \* \*

Në mbrëmje zuri të binte shi. Të gjithë u gëzuam që zuri të binte shi. Kjo donte të thoshte që era do të ndërpritej dhe së shpejti do të dilnim në



gjueti. Dhe vërtet ashtu ndodhi. Era u pre dhe ne pamë tutje në det të hapur se dallgët ishin fashitur.

Shkuam andej nga pishat, përballë Sazanit.

U shpërndanë llambat dhe në anije u vendos qetësia.

Atë natë kisha roje.

Ne ishim shtrirë në rërën e vakët, aty në breg të detit, nga dukeshin dritat e portit. Ajo ishte e gëzuar atë natë.

— Petrit... kur do të kthehesh?

— Nuk e di.

— Ti asnjëherë nuk e di kur do të kthehesh.

— Të ka thënë gjë babai?

— Jo.

— Ti je e mirë.

— Nuk jam.

— Je e mirë dhe unë të dua shumë.

— Vërtet?

— Të dua shumë. Kur jam në det shikoj brengun, por nuk e dalloj dot punishten tuaj të rrjetave. Megjithatë të mendoj brenda duke qepur tratat.

— Mua më duket salla si det.

— Ina ime! — E putha. Ajo ishte rrasur në gjoksin tim dhe unë ndjeja se si i rekëtinte krahërori.

— Ti je peshkatar i zoti — më tha.

— Jam.

— Më ke zënë keq në grepin tënd.

— E di.

— Çfarë po bën? — më pyeti kapedani.

— Mendoj — i thashë.

— Për se mendon?

— Diçka për veten.

— Edhe unë për veten mendoj dhe ja përpëlitem në shtrat e nuk më zë gjumi. Thashë të dal njëherë dhe dola. Mendoj shumë gjëra dhe hop më del gjumi. Njëherë për gruan që s'e kam më, njëherë për fëmijët dhe përpëlitem në shtrat. Kam një vajzë. Ka filluar të rritet. Është në shkollë të mesme. Rri deri natën vonë duke lexuar romane. Mosha. Vajzat janë të dashura. Vajzat janë bela për prindin. Bela e dashur! Ja, rri e mendoj për fëmijët. Ç'do të bëhen ata? Ne u rritëm si u rritëm: herë me bukë, herë pa bukë. Ata i kanë të gjitha, prandaj duhet të bëhen të mirë. Çupa më shkon mirë në shkollë dhe nuk ja kam shumë frikën, djali është ca çapkën. Rri e i flas kur bën gabime. Më dëgjon, po sa para bën. Unë dua që ai të bëhet i mirë dhe të mësojë. E kështu gjithnjë në merak jam.

Sonte nuk më zë gjumi nga shokët. Si thua ti, djalo... kanë të drejtë! Nuk jam i keq. Nuk di se ç'bëj nganjëherë, por nuk jam i keq. Erdha në det kur akoma isha fëmijë. Nuk dija ç'ishte të peshkuarit. Kishim ca varka të vogla dhe gjuanim me rrjeta, bregut të detit. Ja kështu u mësuam ne me detin. Pastaj na erdhën anije prej hekuri. Ne nuk dinim se ç'ishin anijet prej hekuri. Edhe ata që ishin më të vjetër, nuk dinin më shumë në punët e detit. Na dërguan jashtë për të mësuar. Kur u kthyem më bënë kapedan. Ne nuk kishim eksperiencë në gjuetinë me trata kçi. Sektorët që njihnim kishin pak peshk. Duheshin zbuluar zona të tjera peshkimi. U nisa me varkën nga bregdeti i Jonit. Nuk kishim dalë asnjë herë andej për gjueti. Anija jonë doli e para. Na mbetën në fund të detit tri trata deri sa i mësuam shtigjet e Jonit. Ja kështu. Njeriu di se

ç'është dhe nuk di se ç'do të bëhet nesër. Kisha një grua të mirë dhe ajo më la. Djalli ta marrë këtë punë! Shokët kam. Pa shokët nuk jetoj dot! Po edhe këta i paskam fyer. Mbaj mend një herë, se duke peshkuar na ra një shok në det. Ai ishte me gjithë rroba dhe nuk notonte dot. Ishte dimër. Ftohët, por atë nuk e lamë të mbytej.

— Kush e shpëtoi?

— Nuk ka rëndësi ajo punë. Shpëtoi... Si thua ti, djalo? Shokët kanë të drejtë. A thua do të ma falin?

— Shokët gjithmonë kanë të drejtë. Ata të duan.

— Mirë thua...

— Shokët të duan, — thashë.

1970

## MJEGULLA E ÇARË

Autokolona ishte ndërprerë tek ajo kthesa e ngushtë, ku pjerrësia ishte shumë e madhe dhe zbriste thikë deri në hon. Në të gjithë autokolonën, që nga oficerët efektivë, ushtarët dhe deri te zboristët flitej për një maqinë që ishte batuar keq dhe kishte shpëtuar mirë pa rënë në humnerë.

— Jetëgjati nuk bëhet kurrë jetëshkurtër.

— Kur të kthehet në shtëpi le të shtrojë një darkë të mirë që shpëtoi.

— Mirë që s'kishte ushtarë në maqinë.

Pjesa më e madhe akoma nuk e dinin se cili ishte jetëgjati që duhej të shtronte një darkë.

Gjithë natën kishte rënë shi dhe në mëngjes kishte pllakosur mjegulla. Ajo ishte e dendur dhe mbështillte gjithshka me një bardhësi të ngjeshur. Rruga ishte e keqe dhe me shumë baltë.

Nëpër mjegull kurrize bredhash të lartë; maqina që gulçonin duke vërtitur rrotat nëpër baltë. Gjelbërimi i pyllit dhe i ushtarëve të mbështjellë nga mjegulla e lagësht. Ajo ishte një rrugë e re, e panjohur, e shënuar vetëm në hartat ushtarake. Shoferët nuk kishin kaluar në asnjë rrugë të ngjashme me të.

Prozhektorët mplekseshin me njëri-tjetrin për të depërtuar mjegullën. Kështu për orë të tëra, derisa autokolona u ndërpre tek një kthesë.

Maqina ishte batuar keq. Gurët ndanë rrugës kishin shkarë dhe ishin puthitur pas një peme të vogël. Diferenciali i pasmë kishte zënë vend në tokë, kurse tri rrotat e tjera qëndronin në ajër.

Shoferi në fillim nuk kuptoi asgjë. Kishte frenuar dhe kishte dalë nga kabina. Kur kishte parë honin, i kishte ikur shumë gjak nga fytyra. Ishte nemitur dhe thithte vazhdimisht cigare. Ai kishte harruar se duhej të merrej me maqinën e tij.

\* \* \*

Ajo ngjante e shëmtuar dhe e harruar me ato rrota të ngritura përpjetë. Mjegulla e kishte mbuluar dhe të dukej sikur e vështroje pas një vazoje të mbushur me ujë.

Rreth e rrotull njerëz me uniforma të gjelbëra që afroheshin e shikonin, habiteshin dhe hiqeshin mënjanë për të dhënë mendime!

Ai që duhej të shtronte një darkë qëndronte i mënjanuar, ulur mbi një gur të madh. Vetëm cigare nuk harronte të pinte.

Nga rruga përpjetë, disa dhjetëra metra ku fillonte kthesa, autokolona vinte me gulçima që këputeshin në mes, mbyteshin e shuheshin nëpër mjegull.

Përpara maqinës së rrëzuar, nëpër rrugën që dredhonte pyllit, u nisën një komandat dhe një komisar të lajmëronin kreun e autokolonës të qëndron-

te. Pas pak u dëgjuan të shtëna. Ato plaseshin nëpër kurrizet e maleve dhe pemve si një gurgullimë. Mjegullën e çau ngjyra e kuqe e një fisheku shenjdhënës.

Ai që duhej të shtronte një darkë akoma qëndronte tek guri i madh. Ndër mend i vinin portretet e dy fëmijëve të tij. Zëri i afërt dhe i dashur i gruas. E puthura e ndarjes. Lëvizja e dorës dhe e doçkave nga ballkoni kur ai u nis. Honi që pa kur hapi derën e zbritj nga kabina.

Ai e dinte se duhej të lëvizte, të bashkohej me njerëzit që kuvendonin përpara maqinës, e cila mund të ishte bërë gërmadhë, të dëgjonte e diçka të vendoste. Dinte bile se një fjalë e urtë popullore thotë që «gomarin, i zoti e nxjerr nga balta». Por prapë s'vendoste për asgjë. Vazhdimisht thithte cigare.

— Kur do të ktheheni, Titi?

— Ku ta di?

— Titi — ajo i ishte rrasur pranë krahërorit dhe po merrej me jakën e peliçes së gjelbër, — të më pëlqen kur vishesh ushtar, më dukesh simpatik. Ai nuk i tha asgjë. Vetëm e puthi.

— Ruaju mos të ftohesh. Nëpër male bën akoma ftohët.

Ai përsëri e puthi.

Maqinën e tij e kishte futur në oficinë për ta riparuar. Kur kishte shkuar në shtëpi, kishte gjetur fletën e zborit. Të qëndroje pa punë për ditë të tëra pa vërtitur timonin, për të ishte e mërzitshme. Koha kur maqina riparohej atë e lodhte, e dembeloste dhe

i zgjonte një humor të keq. Këtë radhë do të kish-  
te maqinë. Kur të kthehej nga zbori, ajo e tija do  
të ishte riparuar. Atëhere do të ishte përsëri mbi  
timon. Ndjeu lehtësim dhe u nis i kënaqur. Me vete  
kishte marrë kujtimin e ndarjes së ngrohtë.

Ai akoma nuk vendoste të ngrihej nga ai gur.

\* \* \*

Një veriçello kishte ardhur pas maqinës së ba-  
tuar. Kishin lidhur me kavo pjesën e prapme të  
shasisë, aty ku fillonte diferenciali, që mbështetej  
në tokë, dhe e kishin kaluar nëpër pyll pas trungje-  
ve më të forta e të larta. Kavua shtrëngonte maqi-  
nën e batuar që të mos gremisej në humnerë.

Aty afër saj vazhdonin debatet, rriheshin me-  
ndime se si mund ta nxirrnin më mirë.

Nga kreu i kolonës ishte kthyer me marsh indie-  
tro një «GAZ-63» dhe kishte qëndruar disa metra  
më tutje kthesës. Shoferi kishte zbritur nga kabina  
dhe ishte afruar tek grupi i njerëzve që kuvendonin.

Ushtarë efektivë dhe zboristë qëndronin më larg  
të gatshëm për të vepruar sipas urdhërit që do të je-  
pej.

Autokolona ishte këputur në mes.

Për të vazhduar ose duhej hedhur në humnerë  
maqina, ose të nxirrej në rrugë.

Diskutohej që maqina të nxirrej në rrugë e të  
ecte me autokolonën.

Mendime të ndryshme.

Njëri thoshte të mblidheshin të gjithë, të vinin  
duart e ho-o-opp! ta ngrinin maqinën peshë. Të tje-  
rët i treguan atij terrenin e thepisur dhe ai s'e zgjati

më. Një nënkryetar komiteti ekzekutiv, duke qëndruar pak më larg grupit, ngulte këmbë që maqina duhej nxjerrë. Ata të grupit kthenin kokën, e dëgjonin një çast dhe prapë futeshin në debatet e tyre. Midis grupit ishte një shofer i shkuar në moshë me kokën të zbardhur nga thinjat. Koka e tij ngjante me negativin e një filmi.

— Dëgjoni plakun njëherë — thoshte ai që ngjante me negativin e një filmi — Niko, mban mend kur nxorëm atë «Skodën» në Llogara?

— E mbaj — thoshte ai që u thirr Niko.

— Dëgjoni plakun ju! Veriçellua ta heq prapa... kështu... Ai «Gazi-63» përpara... në rregull... Ky bërryli i kthesës të zgjerohet për t'u futur më mirë ai «Gazi-63»... kështu... Po nuk doli, hajt më këpusni kokën.

Shoferët e thërrisnin xhaxhi atë që ngjante me negativin e një filmi.

U dha urdhëri të zgjerohej bërryli i kthesës. Ushtarët efektivë dhe zboristët morën kazmat e lopatat dhe u sulën si në një aksion me goditje të përqëndruar.

Ai shoferi i «Gazit-63» kundërshtonte dhe ngulte këmbë:

— Unë nuk e tërheq maqinën përpara. Rruga është e keqe... Ka rrezik të na tërheqë në humnerë maqina e batuar. I thonë kokë kësaj, ore...

Ai vazhdimisht mallëkonte rrugën e keqe dhe ata që e kishin hapur rrugën.

Një oficer ju hakërrye që ta tërhiqte patjetër maqinën. Ai kundërshtonte.

— I thonë kokë kësaj, ore...

Një kooperativist nga Brataj kishte lënë kazmën



dhe po dëgjonte atë të «Gazit-63». Nuk u përmbajt dhe diçka shau me zë të lartë, pastaj ju hakërrye shoferit se donte rrahur.

Ai i «Gazit-63» s'u ndje më dhe shkoi në kabinën e tij.

\* \* \*

Shoferi i maqinës së batuar ende qëndronte tek ai guri ndanë rrugës.

Ai ishte shkëputur ca nga vetja e tij.

Gjëja më e vështirë është të shkëputesh nga vetja.

Vështronte nga grupi i njerëzve që rrihnin mendime. Dëgjoi atë shoferin që ngjante me negativin e një filmi dhe në mendje i aprovoi ato që tha ai. Kujtoi ditët dhe netët nëpër tërmete, në atë dhjetor, për të cilin u fol aq shumë. Udhëtimet nëpër dëborë. Kujtoi çastet kur e kishte pasur më të vështirë, dhe ky incident nuk ju duk asgjë. Nëpër mjegull vështronte ata që zgjeronin bërrylin e kthesës. Trupat e tyre i ngjanin të trashë, të fuqishëm dhe çdo goditje e kazmës në tokë i dukej si një oshëtimë. Dëgjonte me vëmendje ato që thoshin ata që hapnin bërrylin e kthesës.

U ngrit si ai që ngrihet nga një gjumë i thellë e topitës. U shtriq dhe shkoi drejt «Gazit-63», nga kreu i kolonës.

Ata që zgjeronin rrugën punonin me shpejtësi. Kur punonin kazmat, pushonin lopatat dhe anasjelltas. Ata e dinin se duhej të zgjerohej bërryli i kthesës. Dinin bile se maqina duhej ngjitur në rrugë dhe kishin besim për këtë.

— Do të dalë.

— Keq ka rënë... të shohim.

— Kjo autokolonë është pjesë e marshimit të revolucionit tonë.

Në një grup, një arësimtar po tregonte për atë mëngjez kur në fshat ishte dhënë alarmi dhe kur ata të kooperativës kishin ardhur në shkollë të kërkonin ndihmën e nxënësve dhe të mësuesve. Kishte rënë shi gjithë natën. Lumi kishte vërshyer dhe kishte përmbytur stallat e vathët e kooperativës. Treqind qëngja mund t'i merrte ujët. Kishin vrapuar nxënës të klasave të larta dhe mësues. Ishin futur nëpër ujë dhe kishin marrë secili nga një qengj.

Gazeta lokale kishte shkruar dhe një artikull për këtë rast.

U hodhën lopatat në punë dhe qëndruan kazmat në pushim.

Një tjetër zuri të tregonte për një ciklon të fortë që kishte ardhur nga deti. Era kishte ulëritur duke marrë me vete copa tjegullash, xhamash dhe dritaresh, çatia dhe dyqane ambulante.

Ai tregonte për një qiell gri, që rëndonte mbi qytet dhe dukej sikur do t'i zinte frymën.

Dimri kishte qenë me të vërtetë i ashpër dhe pranvera kishte ardhur e vonët. Në male akoma më e vonë. Vazhdimisht binte shi dhe përhapej mjegull. Në maja dëborë akoma nuk kishte shkrirë.

Dëborë në fund të majit është e mërzitshme dhe e shëmtuar. Rrugët akoma më të mërzitshme dhe gjithë baltë.

Autokolona çante duke rrënuar e gulçuar nëpër këto rrugë.

Male, male, male! Sa shumë male!

Malet janë hijerënda dhe të fusin në mendime. Shqiptari nuk është ndarë kurrë nga malet, ashtu si nuk është ndarë nga pushka, nga këngët dhe nga humori.

Autokolona çante nëpër male, derisa u këput në mes te kjo kthesë.

\* \* \*

— Vëlla... lërmë ta ngas unë, — i tha ai që duhej të shtronte një darkë.

— M'u zhdruk nga sytë! — shfryu ai i «Gazit-63». — Ç'pandeh zotrote, kaq frikacak të dukem?

— Nuk thashë që je frikacak, por desha ta ngas unë...

— Si tha ai ushtari zborist? Duhem rrahur!

— Nuk dëgjova.

— Bukur e tha qeni!..

— Nuk dëgjova.

— Paske qenë me fat.

— Kështu më thonë të gjithë sot. Më këshillojnë të shtroj një darkë.

— Duhet ta shtrosh.

— Nuk çaj kokën për këtë. Ajo nuk do të më shpëtojë në të ardhmen. Më lërë ta ngas unë dhe mos u fry si gjel.

— Nuk të lë. Po deshe hajde në kabinë me mua.

— Po vij në kabinë me ty.

Ata të bërrylit kishin mbaruar zgjerimin. Kishin shtrirë kavon në drejtim të «Gazit-63». Ai u afrua dhe kavon e lidhën. Pritej urdhëri për të filluar tërheqja.



Të gjithë ishin hequr mënjanë për t'u mbrojtur nga kavot në rast se këputeshin.

Veriçellua tërhoqte kavon në lëmshin e boshtit vinç. «Gazi-63» kishte ngulur këmbët fort për tokë, duke rënkuar me gulçima të zgjatura e të mbytura.

Maqina e batuar ndjente t'i dhimbnin kryqet nga tërheqjet. Bënte ndonjë lëvizje e prapë qëndronte në vend.

Nga këndet e mbrojtura dëgjoheshin zëra inkurajues dhe thirrje të gjata, që shuheshin në uturimat ngulmonjëse të motorëve. Nuk merrej vesh se cilëve ju jepnin zemër: shoferëve apo maqinave.

Pas një ore zinxhiri i murmë i autokolonës zuri të lëvizte aty ku ishte këputur në mes. Ajo ecte nëpër ato rrugë malore, mes pyjesh të virgjëra; të shënuara vetëm në hartat ushtarake.

Dielli çau më dysh mjegullën, duke e fshikulluar djathtas e majtas me shkopinj të e rrezeve.

1970

## NËPËR NATËN TONË TE FUNDIT

*Atyre që u diplomuan në vitin 1969*

Ne u larguam vonë, pasi kishim ardhur në qejf. Në përgjithësi ne ishim të trishtuar atë natë, megjithatë nga fundi kishim ardhur në qejf. Zbrisnim poshtë kodrave pranë liqenit artificial duke kënduar dhe duke bërë qyfyre. Me ne ishin dhe ata të inxhinierisë. Filluan thumbat si në kohën kur ishim plotësisht studentë dhe i thërrisnim njëri-tjetri nga dritaret e konvikteve.

— Hekuraxhinj modernë!

— Shkresaxhinj.

— Do t'ju bluajnë ingranazhet gjithë jetën.

— Gërmonjës të mykur të Buzukut.

Nofkat vazhdonin derisa lodhej njëra palë. Atëhere ishim studentë. Tani nuk jemi më studentë, megjithëse një ditë më parë dhamë provimin e fundit. Të nesërmen do të merrnim diplomat dhe atëhere do të ishim kuadro. Pastaj emërimet.

Shokët dhe shoqet këndonin. Unë nuk doja të këndoja. Ju afrova Amardës.

— Edhe pak dhe do të ndahemi. Dua të jem me ty sonte. — i thashë.

Ajo nuk foli. Vetëm tundi kokën.

Shokët e kursit tim vazhdonin të këndonin. Nexhati ja thoshte një këngë të vjetër popullore. Kënga bënte fjalë për një shitës byreqesh. Shokët mbanin iso.

U futa dhe unë në ison e shokëve. Kishim kënduar shumë atë natë: që nga këngët popullore, te repertori i muzikës sonë të lehtë e deri te këngët partizane.

- *Elsa, doja akoma të vallëzoja me ty.*
- *Do të vallëzojmë, Gimi.*
- *Kushedi kur do të takohemi tani.*
- *Në vitin 1974.*
- *Atëhere ndoshta do të jemi prindër.*

Dolëm në rrugën e ndriçuar nga llambat neon, tek korpusi qëndror i universitetit. Shokët e inxhinierisë u ndalën para fakultetit të tyre.

- *Mirë u pafshim, fakultet!*
- *Ndonjëherë do të kthehemi prapë.*
- *Lamtumirë, auditore!*
- *Unë ju afrova Amardës.*
- *Ikim tani. — Ajo tundi kokën dhe më erdhi nga pas.*

— *Natën e mirë, o çift!*

— *Natën e mirë, shokë!*

*Të gjithë e dinin që duheshim dhe s'kishim pse zemëroheshim që po ndaheshim prej tyre. Amarda mbaroi inxhinierinë. Unë filologjinë. Ajo kishte njohuri mbi ingranazhet dhe maqineritë. Unë për Buzukun dhe letërsinë. Ajo do të ishte inxhinierë, unë mësues. Amarda ime! Këtë natë dua të jemi vetëm. Kjo do të jetë nata jonë e fundit studenteske. Ishte mesi i qershorit. Mbrëmjet e Tiranës*

janë të bukura në verë. Qielli blu, me yje. Drita qumështore e llambave ndriçon errësirën me një bardhësi tyli. Ecnim nëpër natën tonë të fundit dhe donim të mos kishte të mbaruar. Unë i kisha kapur dorën. Ajo nuk fliste. Edhe unë nuk flisja. Nuk doja të flisja. Nuk donte të fliste. Edhe në hesh-tje ne merreshim vesh shumë mirë. Kohët e fundit ne rrallë fisnim kur ishim vetëm. Rrinim në ndonjë stol të lulishtes të errët duke dëgjuar frymëmarrjen e njëri-tjetrit. E dija se ç'mendonte ajo. E dinte se ç'mendoja unë.

— Amarda, këtë natë dua të jem me ty!

\* \* \*

U nisëm një ditë shtatori. Do të shpërndahe-shim nëpër dyert e fakulteteve. Të gjithë ishin entuziaztë. Para kohe kishin filluar të më thërrisnin inxhinier. Unë nuk kisha ëndërruar ndonjëherë të më thërrisnin inxhinier.

Udhëtimi ishte shumë i bukur. Ishte e para herë për ne që udhëtonim të gjithë në një autobus. Ai gjëmonte nga këngët, bisedat dhe qyfyret me zë të lartë. Pastaj udhëtimi në tren. Në kabinën tonë ishte dhe ajo bashkë me një shoqe. «Për ku udhëtonte?! Për në Tiranë? Studente? Po... shkonte për herë të parë. Në inxhinieri mekanike? Po, mekanike.»

— Jemi bashkë, — thashë unë.

— Ashtu?

— Po, — thashë unë.

— Gëzohem shumë, — tha ajo.

Rrugës biseduam për shumë gjëra. Në kabinën

tonë ishte dhe një student i konservatorit. Ai fliste për muzikën: për Vagnerin, Verdin, Listin dhe Shopenin. Ne s'kishim dëgjuar ndonjëherë me interes muzikë klasike. Unë i premtova vetes se s'do të lija shfaqje të operës pa parë në Tiranë.

— Keni qenë ndonjëherë tjetër në Tiranë? — më pyeti ajo.

— Po, — thashë unë.

— Unë shkoj për herë të parë.

— Keni kushërinj në Tiranë?

— Xhaxhanë — tha ajo — po nuk ja di shtëpinë. Kam vetëm adresën. Ajo më tregoi adresën.

— Do ta gjejmë bashkë — thashë.

Ajo më hodhi një vështrim të dyshimtë dhe provokues.

— Do ta gjejmë bashkë — përsërita unë.

\* \* \*

Jetë studenteske. Malli për familjen. Drojtje nga pedagogët. Drojtje nga auditorët. Karambole nëpër shkallë. Bibliotekat. Ftohtësia e skedarëve dhe sallave të leximit. Në ato salla shokët e mi zhyteshin në formula. Figura të errëta të gjeometrisë deskriptive. Gërma dhe numra që shtyhen në radhë për të dhënë një kuptim të caktuar.

— Shoqe, më jepni Kadarenë, Agollin, Majakovskin.

— Në ç'fakultet jeni ju?

— Inxhinieri... — Ajo nga habia ngrinte qerpikët e bukur bashkë me supet dhe më sillte librat me vjersha. Habia dhe vërejtjet e shokëve. Unë s'çajja kokën për vërejtjet e shokëve. Një gjë kisha të qartë, nuk do të bëhesha kurrë inxhinier.



Nga dritaret e auditoreve kundroja vjeshtën. Qilimin e verdhë të gjetheve për tokë. Mendime. Pedagogu fliste për determinantet. Unë mendoja për një motiv vjeshte. Mendoja në vargje. Ai shpjegonte dhe mendonte me formula. Unë mendoja dhe shkruaja vargje. Amarda më shikonte. Ne rrinim shpesh në një tavolinë. Më shkundte nga supi dhe më thosh të mbaja shënime. Unë nuk do të dilja inxhinier, megjithëatë mbaja shënime. Akoma s'kishte filluar t'i thërrisja Arda.

— Unë nuk do të bëhem inxhinier, — i thashë. Ajo më dëgjonte e menduar. — Do të kthehem në qytetin tim e do të zë punë.

— Ti e di vetë më mirë.

— Do të kthehem në qytetin tim. Vitin tjetër do të ndërroj degë.

— Ti e di vetë më mirë. Unë do të të shkruaj, — tha.

Atë natë shkuam në kinema dhe unë i thirra për herë të parë Arda.

\* \* \*

— Një froidist do të kishte një dëshirë të çmendur të thyente hënën me gurë duke e quajtur si një llambë të rrumbullakët neoni.

— Sa çudi!

— Kurse ne duam të ketë sa më shumë dritë!

— Ç'ke kështu sonte?

— Dua ty, dua të gjithë njerëzit. Sonte kam shumë dashuri. Eja futemi në lulishte që të puthemi.

A e dini si duket qielli i qershorit, me yje, natën, po ta vështrosh nën pemët?

Si sytë e Ardës...

Mbështolla me gërshet qafën e saj dhe qafën time. U puthëm të mbërthyer nga gërsheti i saj. Arda ime, nusja ime. U skuqa nga ky mendim. Asnjëherë nuk e kisha menduar si nuse. Duheshim, po kurrë nuk flisnim për fejesë dhe gjendje civile. Ne e dinim që do të martoheshim bashkë, por nuk flisnim kurrë për martesë.

Në sytë e saj pashë qiellin dhe yjet që shkrepëtinin.

\* \* \*

Grupe punëtorësh që shkojnë në turnet e natës. Grupe punëtorësh që dalin nga turnet e mbrëmjes. Kalimtarë të vetmuar. Hapa dhe copëza bisedash nëpër qetësinë e natës. Çifte që shtrëngohen pas njëri-tjetrit, shtyhen në fshehtësinë e parqeve dhe lulishteve, dalin nga fshehtësia e parqeve dhe lulishteve. Vetura që zhduken nëpër pasqyrimin e thatë të dritave neon. Reklama me ngjyra të ndezura. Ecnim nëpër këtë natë të flakëritur nga ngjyrrat e së ardhmes. Unë i shtrëngoj dorën. Edhe ajo më shtrëngon dorën.

Autobuse me rimorkio, që i bien kryq e tërthor kryeqytetit. Unë i them të hipim në një autobus. Ajo tund kokën. Ajo gjithshka e aprovon duke tundur kokën. Mbështetem në shtyllën e një llambe neon, pranë një stacioni autobusash. Llamba shpërndan një bardhësi të ngrohtë. Rreth ndriçimit të saj fluturojnë duke zukatur insekte të natës. Unë i vështroj insektet e natës. Edhe ajo i vështtron insektet e natës. Në këtë natë gjithshka na duket e ngrohtë, e bukur. Ne jemi të dashuruar.

— Ku do të jemi pas disa vjetësh, Arda?

— Diku pranë ndonjë kantieri a uzine. Ti do të mësosh fëmijët dhe punëtorët, unë do të jem inxhinierë.

— Inxhinierja ime.

— Jeta jonë do të jetë e mbushur me shqetësimet për fëmijët, njerëzit dhe metalet.

— Inxhinierja ime...

Ai erdhi i zhurmshëm, me një grusht dritash dhe pak njerëz. Hipëm në të. Faturinoja dukej e ngathët dhe e përgjumur. Qëndruam nga fundi. Ajo u mbështet në krahun tim. Autobusi ishte i heshtur. Dëgjohej vetëm kënga e përgjumur e shoferit. Kënga fliste për gërsheta dhe sy të zez. Shoferi këndonte me pasion. Faturinoja mezi mbante ekuilibrin. Koka i anonte herë djathtas, herë majtas. Një herë u përplas në kasetën e të hollave. U përmend, na pa ne dhe kërkoi të paguanim. Unë dhashë të hollat. Ajo na pa edhe një herë dhe filloi prapë të dremisë. Ishte lodhur. Edhe ne ishim lodhur, megjithatë nuk na vinte të dremisnim. Ishte nata jonë e fundit dhe s'kishim kohë të dremisnim. Mund të gëdhinim edhe në të ardhmen, diku në aksione, në zборе, duke pritur fëmijët të na ktheheshin në pleqërinë tonë, por një natë e tillë nuk do të përsëritej kurrë. Ajo ishte mbështetur e tëra pas meje. Unë e vështroja dhe doja ta puthja.

— Pas një muaji ti fillon punën, — thashë.

— Hë-hë!

— Unë shkoj në zbor dhe do të të shkruaj letra ushtarë.

— Do të vij të të takoj. Dua të shoh se si do të më dukesh me rroba ushtarake dhe me kokë të qethur.

— S'ka shqiptar që të mos i shkojë uniforma ushtarake.

— Ke të drejtë.

— Po — thashë — kam të drejtë.

Autobuzi qëndroi në një stacion. Shokët ishin aty, të zhurmshëm dhe plot qyfyre. Edhe kur po ngjiteshin në autobus nuk e ndërprejnë këngën.

— Ç'është kështu sonte. Një orë më parë ata të mjekësisë — tha faturinoja.

— Këtu qenkeni, o çift? — thirrën ata.

— Ashtu si ju. Na ndiqni, apo ju ndjekim ne ju?

Autobusi gjëmoi nga kënga. Ajo ushtonte nëpër rrugët, stacionet. Njerëz që zbrisnin, njerëz që ngjiteshin. Shkundnin supet, qeshnin dhe na jepnin zemër. Shoferi kthente hera-herës kokën nga ne.

— Ku paski qenë, mre çuna! Hajt pra, mshojani!

Vendosi që edhe ai të këndonte këngën tonë.

Zbritëm atje ku u ngjitëm. Ecnim nëpër rrugë.

Një polic u afrua i alarmuar drejt nesh. Kur mori vesh se ç'ishim, vuri buzën në gaz dhe u largua. Flisnim me zë të lartë. Zërat trokisnin në të kaluarën dhe në të ardhmen tonë. Aty ishim të gjithë, pedagogët dhe inxhinierja ime e ardhme.

— Ç'do të bësh, Ndue?

— Do të shkoj në malësi. Unë jam i pari kuadër i lartë që del nga fshati im. Do të kërkoj të punoj në fshatin tim.

Ishim shkrirë të gjithë me njëri-tjetrin dhe kishim pushtuar rrugën. Buritë e maqinave të ralla dhe të vetmuara buçisnin të shqetësuara derisa u hapnim rrugën.

I vështroja shokët dhe shoqet e mia. S'di përse

ata trupa që kishin pushtuar rrugën më ngjanin me një mur të fortë prej betoni. Ata do t'i vinin shpatullat së ardhmes dhe do ta ngrinin më lart.

Në agim u kthyem në konvikt. Studentët e kurseve të ulëta kishin dalë nëpër dritare dhe na përshëndesnin.

Po i shtrëngoja dorën fort së nesërmes.

1970

## UNË NUK NDAHEM KURRË

— Merr një cigare, — i tha Miri atij që kishte përbri duke i zgjatur paqetën.

— Tani sa e fika!

— Merre! — Fredi e vështroi në sy. — Merre de, ç'më shikon ashtu. Keq ke bërë që je ndarë. — Edhe shoferi zgjati dorën për të marrë një cigare. Miri e mbylli dhe e rراسi paqetën në xhep.

— Jo, me ty s'kemi punë, je martuar... ke shpëtuar nga hallet, — i tha shoferit.

Miri vështronte nga dritarja e maqinës rrugën që mbetej nga pas, rrugën e qullur e vende-vende të ndotur me bajga kafshësh. Vështronte grumbujt e reve që shtrydheshin me njëri-tjetrin në qiellin që derdhte shi, pemët e lakuriqta që shfaqeshin e zhdukeshin në mjegullsirën pas murit të lëngët të shiut të shtruar.

— Unë shkoj tek e fejuara në Lushnje. E kam arësimitare, — i tha Miri, Fredit, — keq të ndahesh.

— Hë, mor ti, na lodhe... keq! Sikur u përmbys bota. Gota e thyer nuk ngjitet më, — i tha shoferi Miri, që vështronte nga dritarja.

Përpara dukej një njollë që afrohej gjithnjë e

më tepër, zmadhohej në formën e një gomari dhe të një trupi me qeleshe që kolovitej mbi samar.

— Përse u ndatë? — pyeti Miri Fredin që kishte përbri.

— U ndamë. . .

— Kush ishte fajtor; ti apo ajo?

— Nuk e di. Është vështirë të thuash se cili ishte fajtor. U ndamë!

— Ku shkon kështu?

— Në një fshat. Mbarova zborin pas universitetit dhe tani do të paraqitem në detyrë.

— Ndarja është gjë e keqe, — tha nëpër dhëmbë Miri.

Pllakosi heshtja. Maqina rrëshqiste në asfaltin e lagur. Shoferi kishte tendosur krahët mbi timon. Fredi ja kishte mbërthyer sytë krahut të fshirëses, që përshkonte harqe mbi xham. Miri gjithmonë vështronte nga dritarja.

— Çfarë pune bën ti? — e pyeti shoferi Mirin.

— Topograf. . . kjo s'ka rëndësi. . . dëgjo, byrazer — tha duke e tundur nga krahu Fredin që kishte përbri. — . . . hiç. . . asgjë.

Fredi e vështroi njëherë atë dhe prapë ja mbërtheu vështrimin harkut që përshkonte fshirësja mbi xham.

— Ç'më pihet një cigare! Më jep se m'u mbaruan. — I tha shoferi Fredit.

Të tre ndezën nga një cigare. Shoferi, Miri dhe Fredi, i cili nuk ja ndante vështrimin harkut që përshkonte fshirësja mbi xham. Pinin cigare dhe heshtnin.

— Kam një shok që është fejuar me mblesëri në një fshat. Sa herë shkon tek e fejuara, mbush

disa taketuke me bishta cigaresh dhe ikën i ngrysur. Ç'i thua kësaj ti? — i tha Fredi Mirit.

— ... si the? Ndarjet s'janë të mira. — foli Miri. Heshtën përsëri.

Po e përcillte në tren për në një qytet të afërt pranë linjës hekurudhore. Ajo shkonte çdo dy javë tek të afërmit. Kishte shumë njerëz dhe s'gjetën vende në kabinë. Qëndronin pranë dritares dhe vështronin rrugën automobilistike ku dukeshin dhe zhdukeshin maqinat. Në duar mbante një portokalle, që e kishte blerë në qytet, ta hanin bashkë gjatë udhëtimit.

Konduktorja u kërkoi biletat. Ai ja dha për të dy.

— Dëgjo, Fredi — i tha ajo kur kishte ikur konduktorja — nuk është më mirë të ndahemi?

— Ashtu... Po përse? — Atë ditë gjithë kohën kishin heshtur.

— Dëgjo, Fredi... Nuk të ndjek dot andej nga do shkosh. Unë jam me punë në Tiranë... Nuk dua të iki nga Tirana.

— Vërtet?..

— Më mirë të ndahemi...

Nerva të poshtra! Vërtiste portokallin nëpër duar dhe s'mund të thoshte asgjë. Bluante me vete. Ajo kafshonte buzën e poshtme dhe i hidhte herë-herës ndonjë vështrim rrëshqitas.

— Mirë... Ja të flaka tutje si këto lëvozhga portokalli që po i hedh nga dritarja e trenit. Gjysma e këtij portokalli më takon mua dhe unë po e ha. Gjysma tjetër do të ishte e jotja po të ishim bashkë. Edhe këtë po e ha vetë. Kush është i fituari në këtë



mes? Ti nuk mund të vish me mua, se je e dobët dhe ke frikë nga jeta.

Sapo kishin mbërritur në stacion ishin ndarë dhe ajo kishte shkuar vetëm tek të afërmit.

\* \* \*

Miri kishte shkuar të punonte vullnetarisht disa muaj në hekurudhën e re që po ndërtonin aksionistët.

Rudina ishte mësuese në një shkollë pranë trasesë, që po ngrihej në kufi me fshatin G. Atje u njohën. Vinte shpesh me nxënësit. I jepte disa nxënës për të mbajtur zhalonin dhe për të ngulur pike-tat. Ndonjëherë e ndihmonte dhe vetë.

Nuk ju desh t'i vihej pas, të mendonte fjalë të bukura për t'ja thënë. Dashuria u erdhi vetëvetiu, natyrshëm. Pastaj fejesa. Urimet e shokëve shoqëruar me nga një grusht shpatullave.

Herën e kaluar, kur shkoi për ta takuar...

— Miri... të kam blerë një kravatë. Të pëlqen? Prit, mos më puth! Provo kravatën njëherë ta shoh si të rri.

— Ti je më e mirë se kravata.

— Lëri shakatë, Miri... Më thua ç'bërë për dhomën e gjumit, e porosite?

«Tani që të shkoj, do t'i tregoj faturën për dhomën e gjumit».

Vjet shkua në Tiranë pas Vitit të ri. Atëhere binte dëborë. Ç'bukuri! Njerëz që mbushnin rrugët. Çadra të zbardhura. Të rinj duke sulmuar vajzat me topa bore. Ç'kënaqësi kur ecje në rrugë! Vështroje

pemët që visheshin nga një shtresë kristaline; dëborën që binte butë-butë, e të dukej se hidhnin vallen kaotike moria e insekteve të bardha.

Ajo kishte veshur pantallonat dhe atë pallton ngjyrë rozë. Veshët i kishte mbështjellë me shall. Sa e bukur dukej Rudina! Tek rrugica e parkut i sulmuan disa fëmijë me topa bore. I kishin rrethuar. I qëllonin dhe ata s'dinin si të mbroheshin. Qeshnin.

— Mjaft, or dreqër — thoshte Rudina — mjaft, se na zutë frymën. — Dy prej tyre furnizonin shokët me topa bore.

— Ikim me vrap, Rudinë!

Ata u zunë dorë për dorë dhe çanë rrethimin e bardhë. U larguan ca dhe po i shkundnin dëborën njëri-tjetrit.

— Si u rritëm ne, Rudinë... Pantallonat e mi të vjetër, që nëna i qepte andër mbi andër. Buka e misrit dhe dy-tri kokrra fasule në fund të lëngut. Pak bulmet. Shumë pak bulmet. «Do vijmë kohë të mira — thoshte nëna — fëmijët do të jenë të qeshur, të shëndetshëm, të mënçur.» Këto ja kishte thënë babai. që vdiq fill pas çlirimit nga një tuberkoloz i poshtër.

— Mos m'i kujto këto, Miri.

— Duhet Rudinë... ndryshe, fëmijët tanë s'do të jenë të lumtur.

\* \* \*

— Do flisni një fjalë apo t'ju zbres nga maqina. I kam zët pasagjerët që më rrinë si mumje në kabinë — tha shoferi.

— Pusho... ti je i martuar, i ke mbyllur hallet!

— tha Miri duke vështruar Fredin. Pa zë: «unë shkoj tek e fejuara, kurse ky largohet nga e fejuara.»

— Ç'i thua kësaj ti, shofer?

— Çfarë?

— Ja... unë shkoj tek e fejuara, kurse ky largohet nga e fejuara.

— Gota që thyhet nuk ngjitet më!

— Hë mor, gota, gota... dëgjo mik... shumë keq që je ndarë... unë...

— Nuk ta uroj të ndahesh. S'ka më keq se ndarja — tha shoferi. — Është si ky shi që na mërzi... dreqi ta marrë... si kjo fshirëse që përshkon harqe... Nuk ta uroj, por prapë gjëra që ndodhin.

Miri vazhdonte të vështronte nga dritarja.

— *Miri... Unë do të jem mësuese aty në lokalitetin tënd. E di, Miri, ç'gjë e bukur është të jesh mësuese? Si të të them... Të vjen një fëmijë që s'di asgjë, ti e merr, e përpunon, nxjerr nga duart e tua një njeri që në të ardhmen do të bëhet inxhinier, artist, mjek, punëtor i kualifikuar, apo...*

— *Sa e mirë je ti, Rudinë.*

— *Unë do ta shtrëngoj fort krahun tënd me timin. Kështu do të ecim gjithë jetën. Tani më puth, Miri.*

Fredi s'ja ndante sytë harkut që përshkonte fshirësja mbi xham.

\* \* \*

Gjithmonë grindeshin. Zemëroheshin keq, qëndronin disa ditë pa folur pastaj njëri i kërkonte të falur tjetrit. Ç'punë e poshtër! Të kishin shkëmbyer

të paktën një herë disa fjalë për t'i hyrë në thellësi njëri-tjetrit. Por vetëm ziheshin. Një herë shkuan në poliklinikë, ku ajo do të mjekonte plagën. Po prisnin sa t'u vinte radha.

— Ti je i çuditshëm, Fredi! Të gjithë kërkojnë sa më mirë e më mirë, kurse ti: «Atje ku të ketë nevojë, atje ku të më emërojnë do të shkoj. Bile... do ta kërkoj vetë të shkoj për disa vjet në një vend të vështirë.

— Dëgjo... kush më bëri mua mjek?

— E di, po ka shumë mjekë... Ti mund të qëndrosh në Tiranë. E kupton se ç'do të thotë që në të dy të jemi në Tiranë?

— Im atë ka punuar gjithë jetën për të na rritur. Ai s'pati mundësi të studjonte, po ai luftoi që unë të dilja mjek.

— Mjaft, Fredi! .. Ti je i çuditshëm. Unë s'të kuptoj nganjëherë.

— Ke kohë për të më kuptuar.

Dhe ai mendonte se kishte kohë që ta kuptonte.

Një natë po shetisnin nga rruga «MARSEL KASHEN». Ajo është rrugë e mirë veçanërisht në vjeshtë. Të hipin në kokë mendime të çuditshme kur ecën mbi kërcitje gjethesh. Frynte erë. Gjethet hidhnin vallen e tyre të fundit mbi asfalt.

— Edhe disa muaj dhe në këtë rrugë do të vijmë të llangosur me baltëra fshatrah.

— Mos mendo kështu. Hajt të mendojmë për diçka tjetër, Fredi... ti je mjek këtu në Tiranë. Na kanë dhënë një hyrje në një blok apartamentesh. Ne fillojmë jetën nga e para. Në fillim dy lugë, pastaj karriget, radion, më vonë kolltuket, frigoriferin...

— Mjaft... unë s'e përfytyroj jetën kështu.

Një frenim i çmendur mbi asfaltin e lagur.

— Ah, këto qerre... Ju... po më tërboni me këtë heshtjen tuaj. Për ideal do t'ju zbres nga maqina... Rrini si mumje e molloisni me vete.

— E ke të pjekur ti, byrazer, se je i martuar.

— E çfarë, se jam i martuar?

— Ja kështu, je i martuar dhe ke shpëtuar nga hallet.

— Më kujtohet një burrë që e kishte lënë grua-ja. Diku nga jugu më duket — zuri të tregonte shoferi — Ndala për të ngrënë diçka, kur dëgjoi të shara në pijetore. I ishin mbledhur njerëz përreth dhe nxirrnin kunjin me të. Ai qe dehur e bërë furtunë. Përplaste shishen mbi tavolinë e thosh: «Lermë se do vete ta vras!» E, mor miq, gota që thyhet nuk ngjitet më.

Fredi përmes harkut që përshkonte fshirësja, vështronte qiellin, që kishte tendosur nervat në tërë hapësirën e tij, shiun që binte mbi rrugë dhe, tutje, fusha të kredhura në baltë; diku të gjelbëruara, diku të verdha, vende-vende të përzhitura e të murrme, si pas një zjarri që shuhet.

— Të dua. Fredi, por nuk të ndjek dot. Më vjen keq për ty, më kupton?

— Mos të të vijë keq se do të të rrah. Ti nuk mund të dashurosh. Dashuria jote u trembet buçimave të motorizuara, këtyre rendjeve të rrotave të trenit mbi shina, tringëllimave «prozaike» të jetës. Ti do monotoninë e komfortit, këngën e çajit, që zien mbi stufë, do...

— Ndarjet nuk janë të mira. — tha Miri — Dëgjomë, të lutem... edhe ti mbi timon. — Ai ktheu tërë trupin nga ata. — Unë nuk ndahem kurrë... dëgjoni... ju pa tjetër mendoni se unë diçka do të kem me të fejuarën, që them kështu. Ç'mendon ti që shkon në fshat?

— Ashtu mendoj... — tha Fredi.

— Ja ku po ta them: ne shkojmë shumë mirë dhe jemi të lumtur. Mua më vjen keq kur dëgjoj për ndarjet, nuk mund ta përfytyroj dot këtë. Pak më parë the për një shokun tënd që është fejuar në një fshat. Ai largohet nga e fejuara i ngrysur duke lënë pas disa taketuke me bishta cigaresh. Përse ndodh kjo?

— Sepse ka akoma shumë fanatizëm. Ata nuk mund të shkëmbejnë dot dy fjalë. Vetëm fshehur nga njerëzit e familjes. I vjedhin fjalë njëri-tjetrit duke përgjuar hapa apo kërcitje dyersh. Më tregonte se një ditë ishte mërçitur dhe kishte shkuar të hidhte një gotë në bufenë e kooperativës. Kur po kthehej, ishte errësuar fare. Vështronte llamburitjen elektrike të dritave të fshatit, rrugët gjithë baltë, me gjurmat e rrotave të qerreve dhe mendonte. «Tani mund të ecja në të tjera rrugë për të shkuar tek e fejuara.» Ata u fejuan me mblesëri dhe mblesëria të shpie në rrugë që s'i ke përfytyruar ose që s'ke dëshirë të kalosh.

— Si u fejove ti? — e pyeti Miri Fredin.

— Unë... Më pëlqente dhe e ndiqja pas. Sa më ka lodhur! Një herë i dhashë të më priste një biletë kinemaje kur ajo ishte në radhën e grave. Gjatë filmit atë e kisha përbri. I preka dorën dhe ajo s'tha gjë. Pastaj e pamë gjithë filmin me duar të zëna. Kështu filloi...

Fredi u mbështet mirë në sedilje dhe i drejtoi sytë nga dritarja. Vështronte ato dy njollat e reve nga perëndimi që ngjanin me dy forma demash, që i hakërrehen njëri-tjetrit.

Përmes harkut që përshkonte fshirësja, ai pa lumin, një urë të madhe betoni mbi të, pastaj një mur të madh zhavorri që zgjatej në formë harku. Atij i dukej si një pritë gjigante në një fushë të hapur.

— Ç'punë është bërë këtu, — thoshte shoferi — kam punuar një muaj me maqinë. Kolona të tëra maqinash ngarkoheshin me zhavorr tek lumi dhe i shkarkonin aksionistët. Rini heroke kjo!

\* \* \*

Ecnin ndanë trasesë së re të hekurudhës.

— Ja... këtu kemi bërë natjet e para me Rudinën.

— Çfarë the?

— ... tek ajo pema... E shikon? Atëhere, kur uleshim e çlodheshim nën të pas punës... me Rudinën, të fejuar, ishte plot gjethe. Nën atë pemë hanim ushqimet që kishim marrë me vete. Sa na shijonte kur hanim.

.....

— Zbrit, arrite! — i tha shoferi Mirit që kishte humbur në mendime duke vështruar nga dritarja.

— Çfarë?

— Në Lushnje.

Mori në kabinë plaçkat e tij. Doli jashtë dhe hapi çadrën. U kthye pasi bëri disa hapa.

— Na paratë, se harrova. Dëgjo... — tha duke ju drejtuar Fredit, — keq të ndalesh... por... ku ta di... ndoshta mirë keni bërë.

Ata e panë tek humbiste nëpër shi nën çadër dhe mbi galloshet. Shoferi ndezi maqinën.

1970



## NJERËZ TË MIRË

— Në qoftë se njerëzve do t'u numroheshin vjetët sipas orëve të punës, shoferët do të dilnin të parët në pension. — tha Aliu.

Unë nxora bllokun dhe e mbajta shënim këtë. Aliu po më vështronte.

— Çfarë po shkruan? — pyeti.

— Më pëlqeu ajo që the dhe e mbajta shënim.

— Nuk shoh asnjë arsye që të shkruash. — tha duke ngritur supet.

E pashë që nuk i erdhi mirë.

— Hajde, gëzuar! — më tha dhe e bëri bromp me gotën time.

Aliu ishte shofer dhe shoku i mikut tim Velo. Sa herë vinte për ndonjë rrugë në zonë të naftës, një grup shokësh, me Velon në krye, organizonin një darkë të vogël për Aliun. Velua më kishte folur shumë për të dhe unë prisja nga çasti në çast që ta njihja. Njohja jonë u bë në kushte jo të këndshme, dhe unë dyshoj se shoferit Ali nuk i kam lënë përshypje të mirë.

Po kthehesha nga fshati R. ku kishim mbledhjen e këshillit pedagogjik. Rruga nuk është aspak

e lehtë sidomos në vajtje. Një e përpjetë malore që të zë frymën. U ktheva i lodhur dhe i mbytur në djersë. Menjëherë u futa në klubin e Barbës. Në një tavolinë më ftuan të pi një gotë raki dhe unë nuk kundërshtova. Isha lodhur shumë. Para banakut, në një tavolinë tjetër, ishte ulur Velua me një burrë rreth dyzet vjeç. I huaji ishte i gjatë, i thatë dhe shumë i shkathët në të folur. Unë vështrova njëherë andej dhe pashë Velon, që më tregonte atë burrin dhe diçka po i thoshte për mua. Dëgjova vetëm: «është shoku im... është numër...» dhe u ktheva i tëri në tavolinën time.

Atë natë nuk isha në qejf aspak. Isha i lodhur dhe po kotesha për gjumë. U ngrita dhe shkova në banak të porosisja darkën. Velua u ngrit dhe më përshpëriti në vesh:

— Prit... do të hamë e do të pimë të gjithë bashkë. Sa të rrallohen edhe ca. — U ula në tavolinën e Velos dhe u prezantova me shoferin Ali.

Në klub filluan të rrallohen njerëzit. Barba bashkoi dy tavolina. Një nga një erdhën ata të darkës. I njihja të gjithë: kuzhinieri, magazinieri, xha Hamiti, Barba dhe një shok i Aliut, që kishte ardhur me të në maqinë. Kuzhinieri shkoi tek sporteli dhe zuri të sjellë në tavolinë mish të pjekur me patate.

Filluam të pimë. Unë, Velua dhe xha Hamiti raki. Të tjerët verë.

Aliu zuri të tregonte për të dhjetën herë se si ishte njohur me Velon. Velua ngulte këmbë që ta tregonte vetë.

— Jo — thoshte Aliu — do ta tregoj unë. Po vija me maqinë për këtu. Në Peshkëpi ndalova. Më del ky e më thotë: «Jam punëtor nafte, më merr

deri. . . ». «Jo — i them — jam me ngarkesë». Ky nuk bëri zë. Sa ktheva krahët unë, ishte ngjitur lart. E pashë njëherë dhe e kuptova se ishte e kotë të bëja llafe me të. Kur arritëm këtu, ai zbriti dhe më ftoi të pinim një fërnjet. Pranova. Na pëlqeu muhabeti dhe u bëmë shokë. Vonë mora vesh që ky nuk qenka punëtor por inxhinier.

Pastaj ra muhabeti i profesioneve dhe Aliu tha atë punën e të dalit në pension. Atij nuk i erdhi mirë që unë e mbajta shënim.

— Nuk më pëlqejnë ata që shkruajnë nëpër darka. — tha.

— Ke të drejtë — thashë — por nuk desha ta harroj këtë.

Të gjithë kishin ardhur në qejf veç meje. . . Isha shumë i lodhur dhe qepallat po më kapiteshin për gjumë. Djalli ta marrë! Atë natë nuk duhej të ndjeja lodhje! Kuptova se nuk po i lija përshtypje të mirë atij shoferit. Qëndroja pasiv në bisedat e tyre. Aliu tregoi për debatin që kishte patur me një pasagjer. «E di — i kishte thënë pasagjeri — në këtë makinën tënde edhe unë kam pjesë qoftë edhe një vidë». Aliu kishte hapur kasetën dhe kishte nxjerrë një vidë. «Na — i kishte thënë — merre atë që të takon dhe mos më çaj kokën!» Të gjithë qeshën. Unë vura buzën në gaz. Shoferi Ali më vështroi dhe, me sa duket, nuk i erdhi mirë që unë vetëm vura buzën në gaz.

Unë u shkunda një çikë. Fillova të marr pjesë në bisedat. Aliu tregoi diçka nga një libër dhe desh të dinte titullin e autorin. Mua m'u kujtua dhe ja thashë edhe titullin, edhe autorin.

— Paska kujtesë të fortë — më tha.

— Jo — thashë — profesorët gjithmonë janë ankuar për kujtesën time.

— Paske kujtesë të fortë.

Xha Hamiti ja kishte marrë këngës: «Syrin ulli, vetullën kalem...» Barba i mbante ison. Pastaj xha Hamiti e ndërpreu këngën. «More nariqot... na rope, more nariqot...» — i thoshte Barbës. Barba, i shkurtër, i trashë, me faqet të kuqe dhe kokën tullë, ku reflektonte drita si në një hënë të plotë, qeshte dhe i numronte gotat që pinte xha Hamiti.

— Haka hakë... na rope... pikë vijë.

Dëgjonin ata të dy dhe kukuriseshin së qeshuri.

— Narta na qenka me namë... Dikur na pas-kërka pasur edhe një universitet... — thoshte xha Hamiti.

— Ashtu është, more fërnetar dhe rakip. — Xha Hamiti e kishte qejf fërnetin në mëngjez dhe rakinë në darkë.

Filluan të tregonin qyfyre.

Xha Hamiti tregoi se, kur kishte mbaruar shkollën në kohën e Zogut, desh kishte shkuar me bursë në Rumani. Qeveria Rumune kishte caktuar dhjetë bursa për fëmijët e të varfërve shqiptarë. Kishte shkuar me një mikun e tij tek konsulli rumun.

— Me gjithë qejf — i kishte thënë konsulli rumun — por personat i vendos qeveria shqiptare.

Kishte arritur deri në zyrën e ministrit Mehdi Frashëri. Ai i kishte premtuar se do t'i jepte bursë dhe i kishte mbajtur shënim emrin. Ishte kthyer i gëzuar në shtëpi. Pas tri ditësh kishte lexuar në gazetë se Mehdi Frashëri kishte ndërruar post.

— Kështu mbeta pa vajtur në Rumani dhe fillova tregëtinë.

— Ha-ha-ha! Po të kontrolloheshin arshivat, në ndonjë bllok të Mehdi Frashërit mund të gjendej emri i xha Hamitit! — Si urdhëron... haka hak.

A kishte vënë pare të madhe xha Hamiti me tregëtinë? Gjepura... ç'pare mund të nxirrej nga një dyqan i vogël ku shiste rosto, bërçolla dhe kukurec?

— Ky po... ky nariqoti... — tha xha Hamiti. A kishte fëmijë të rritur xha Hamiti? Plot shqyr; njërin të martuar, tjetrin profesor, tjetrin...

— Të të rrojnë, xha Hamit. — tha shoferi Ali.

— Të lumtë goja, o djalë!

Aliu ishte rreth të dyzetave, kurse xha Hamiti deklaronte se ishte 112 vjeç.

— Hop, xha Hamit... na gënjeve.

— Me tërë mend e kam.

— Na gënjeve, xha Hamit.

— Jam rrumbullak 112 vjeç, sepse edhe natën nuk bëj gjumë. Huff... huff shfryj dhe shoh ëndërra. Jetoj edhe në gjumë.

Të gjithë qeshën. Sa keq që nuk mund të qeshja edhe unë!

— Mos je i lodhur? — më pyeti Aliu.

— Jam ca.

— Ikë më mirë! — tha Aliu.

— Do të rri dhe ca. — thashë.

Atë e thërrisnin të gjithë Barba me përjashtim të një fshatari, që hyri në klub dhe i tha xha barba. Klubi atëhere gjëmoi nga të qeshurat.

Fshatari vështroi përreth me habi, mendoi se ata qeshnin për hesap të tyre dhe vazhdon t'i thërrasë edhe sot e kësaj dite xha Barba.

Ky barba ka qejf të notojë në të kaluarën. Ai tregoi për një vendim që kishte marrë një pasha

turk, që nartiotët të mos e shfrytëzonin gjolin. Fshatarët ishin alarmuar të gjithë. Të mos shfrytëzoje gjolin, domethënë të vdisje urie. Ishte mbledhur pleqësia e fshatit dhe kishte marrë një vendim: të dërgohej një përfaqësues nga fshati tek Sulltani. U mblodhën të holla, zgjodhën një mesoburrë që dinte turqisht dhe e nisën.

— Gënjen, more nariqot... gënjen... haka hakë.

— Pusho, ti, fërnetar dhe rakip!

Dhe ishte nisur përfaqësuesi. Fshati kalonte ditët, muajtë, vitin e parë të ankthit në pritje.

— Shkurt, more nariqot... e drejta nuk fitohet me lutje por me këtë...

— Rri urtë, more... rri!

— Nejse, Barba... si përfundoi? — ndërhyri Velua.

— Po ky nuk të lë, xhanëm... I dhanë ca shkopinj dhe e lanë të kthehej në Nartë...

— Të thashë... e drejta nuk fitohet me lutje...

Velua tregoi për një natë kur gjëmonte dhe binte shi me gjysma. Isha edhe unë atë natë. A e mbaja mend unë? Po, e mbaja mend. Kishte rënë gjithë ditën shi dhe vazhdonte të binte paprerë akoma gjatë natës. Ne kishim rënë për të fjetur. Erdhi një nga ata të dezurnit dhe tak-tak në portë.

— Velo, o Velo!

— Ç'është, more?! — foli Velua i përgjumur.

— Ka plasur tubacioni i naftës. — thoshte zëri i alarmuar.

— Erdha — tha Velua.

Unë e ndjeva tek vishej. Luajta në krevat dhe u ngrita ndenjurr.

— Ka plasur tubacioni — tha Velua.

— A të vij dhe unë me ty?

— Ç'do bësh që të vish...

— Kam qejf! — thashë.

Dolëm që të dy. Binte shumë shi. Orientohe-  
shim vetëm nga shkrepëtimat që ndriçonin disa se-  
konda. Shkuam tek përgjegjësi i një pusi t'i kërko-  
nim një saldator. E thirrëm tek porta. Ai pyeti nga  
brenda se kush ishim dhe çfarë kërkonim. Velua i  
tha se donim një saldator. «Saldator?!» Ai nuk kish-  
te saldator për ne. Saldatorin e kishte për vete dhe  
nuk e jepte.

— Urdhëro more të vijë saldatori, se po der-  
dhet nafta kot. — thirri Velua i nxehur.

— Në asnjë mënyrë... saldatorin nuk e jap...  
Ikni tani!

— Sa i poshtër! — mërmëriti Velua me vete.  
Ikëm që andej nëpër shi. Shkuam në dhomën  
ku ishte saldatori. Ai erdhi sapo i thamë. Hipëm në  
maquinën e zjarrfikëses. Shi dhe baltë. Shkrepëtima  
që të merrnin mendjen dhe të verbonin sytë.  
Shkuam deri në njëfarë vendi me makinë dhe zbri-  
tëm. Maqina nuk ecte më tutje. Kishte shumë baltë  
dhe rrotat xhironin në vend. Zbritëm dhe shkuam  
më këmbë nëpër shi. Me vete kishim marrë ca stafa.  
E dinim që nuk mund të saldonim, por, megjithatë  
saldatriciën e kishim rimorkiuar pas makinës së  
zjarrfikses. U lagëm dhe u bëmë qull. Ecnim gjatë  
tubacionit për të gjetur vendin ku ishte çarë dhe  
derdhej nafta. E gjetëm. Nafta hidhej përpjetë me  
presion. Punuam shumë derisa ai saldatori vuri sta-  
fat dhe nafta nuk vazhdoi të rridhte e të vente dem.

U kthyem afër mëngjezit, të lodhur, të lagur  
dhe të llangosur me baltë.

— Paskeni hequr atë natë. — tha shoferi Ali.  
Përpoqëm gotat të gjithë. Barba kishte ardhur në qejf dhe zuri të këndonte një këngë të vjetër dashurie.

Zunë të këndonin të gjithë pas avazit të tij, veç meje.

— Po ti, përse nuk këndon? — më tha Aliu.

— Nuk jam në qejf. Jam i lodhur dhe kam gjumë, — thashë.

— Shko më mirë të flesh, — tha ai me indiferentizëm.

— Mund të qëndroj edhe ca! — thashë.

Pastaj ata zunë të këndonin një këngë labçe. Kënga bënte fjalë për një bari, i cili tregonte se ku kishte qenë një natë më parë. Ai bariu kishte ecur nëpër natën me hënë. Dëgjoheshin lenjet e qenve. Qentë kishin zgjuar Miloren dhe ai bariu kishte bërë dashuri me të. Trupi i Milores i ishte dukur bariut si shkëlqimi i borës në hënë.

— Këngë e bukur! — tha shoferi Ali.

— E bukur! Labi është poet, — thashë.

Në klub hyri Manja, ai punëtori pesëdhjetë-vjeçar dhe i pamartuar. Manja kishte bredhur në sektorë të ndryshëm nafte, për shtatëmbëdhjetë vjet me radhë dhe shpesh fotografia e tij ndodhej në stendat e të dalluarve.

— Një kafe, Barba! — tha Manja.

Barba shkoi të bënte kafën. U dëgjua zhurma shurdhuese e ekspresit. M'u duk se po vija nga shumë larg. U shkunda ca dhe fillova të tregoja për atë kryetarin e këshillit, që jepte gjithmonë udhëzime dhe direktiva sikur të ishte vetë shefi ynë i



arësimit dhe që në një mbledhje tonën, të këshillit pedagogjik, kishte thënë se arësimitarët duhej të mobilizoheshin dhe ta nxirrnin kalueshmërinë e nxënësve 110%.

Ajo që tregova pati shumë sukses dhe ata u shqyen gazit. Pastaj unë u stepa dhe zura të dremis në karrigen time. Velua tregonte diçka nga koha e studentllëkut. Unë nuk dëgjoja më asgjë. Ata kishin ardhur të gjithë në qejf dhe, me sa duket, unë po i pengoja me heshtjen time. Isha më esëlli midis tyre.

— Mendoj që ta lëmë këtë shokun të largohet se është i lodhur — tha Aliu për mua.

E vështrova shoferin Ali dhe kuptova se unë kisha filluar t'i mërzisja. Nuk doja të largohesha, por megjithatë u ngrita. U përshëndeta me të gjithë dhe dola.

Në të dalë dëgjova një «Haka-hakë... pikë vijë...» të Xha Hamitit. Kur dola, më ra në hundë era e gazit. Pashë flakët andej nga përroi, ku digjej gazi. Vështrova qiellin. Ishte vërtet një natë e bukur dhe e freskët vjeshte. Nëpër fjetoret dëgjoheshin akoma zërat e punëtorëve. Disa luanin letra a domino dhe përpjekjet e gurëve e të zërave tingëllonin të forta në atë natë të qetë. Në qendrën e zonës, dy maqina gulçonin me motor të ndezur, dhe mezi prisnin të niseshin «me revan». Punëtorët drejtoheshin nga maqinat. Ishte koha kur ata shkronin të ndërronin turnet nëpër pusët. Shkova të fle. Gjumi më kishte dalë dhe isha bërë akoma më esëll. U shtriva në krevat. Mendova Aliun, që të nesërmen në mëngjez do të zhdukej midis rrugëve pambarim. Do të kalonin javë, do të dëgjohej përsëri boria e

maquinës së tij nëpër këto gryka dhe shokët do të  
mblidheshin përsëri të organizonin një darkë për të.  
Atë natë unë ua kisha prishur darkën. Mendoja  
për ta...

Gjumi nuk më zinte.

U ngrita dhe u vasha. U drejtova nga klubi.

«Ata nuk do të më dëbojnë...» — mendova.

1970

## PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Fëmija e uzinës .....	3
Yjet .....	12
Maria .....	19
Bota e Dules .....	30
Drejt fenerit të ndezur .....	39
Sekreti për të qenë diell .....	45
Atë verë kur filloi garbia .....	58
Mjegulla e çarë .....	70
Nëpër natën tonë të fundit .....	79
Unë nuk ndahem kurrë .....	88
Njerëz të mirë .....	99